



RAPORT I VEÇANTË

**“MBI NIVELIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË PËRKUJDESJES
REZIDENCIALE
PËR FËMIJËT NË SHTËPI FËMIJE DHE SHTËPI FOSHNJË”**

Prill-Qershor 2016

Tiranë 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

RAPORT I VEÇANTË

**“MBI NIVELIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË PËRKUJDESJES REZIDENCIALE
PËR FËMIJËT NË SHTËPI FËMIJE DHE SHTËPI FOSHNJË”**

Prill-Qershor 2016

Tiranë 2016

Ky botim u mundësua financiarisht nga Programi Danez i Fqinjësisë



The Danish Neighbourhood Programme

FJALA PËRSHËNDETËSE E AVOKATIT TË POPULLIT

Kur flitet për fëmijët, dhe veçanërisht për ata pa përkujdesje prindërore, çdokush me gjykim të kthjellët ka një ndjeshmëri që shkon përtej klisheve. Jemi ne, që të gjithë së bashku, duhet të përpiqemi maksimalisht që këtë ndjeshmëri ta përkthejmë në veprime konkrete me qëllim që t'u sigurojmë këtyre fëmijëve kushtet për ta jetuar maksimalisht fëmijërinë e tyre. Jemi po ne që duhet të punojmë në drejtim të interesit më të lartë të tyre, duke ofruar zgjidhje të menjëhershme e të përshtatshme, në mënyrë që të garantojmë mundësitë që këta fëmijë të rriten në mjedise përkujdesje, që ofrojnë gjithë mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme. Fakt është që në Shqipëri, dhe jo vetëm, ekziston një hendek midis të drejtave dhe realitetit të zbatimit të tyre. Mjediset e papërshtatshme në të cilat rriten fëmijët në përkujdesje alternative në institucione e dëmtojnë zhvillimin dhe i bëjnë fëmijët vulnerabël ndaj një sërë dhunimesh të këtyre të drejtave.

Si Avokat i Popullit, njëkohësisht baba i dy fëmijëve, besoj se çdo lloj investimi tek fëmijët, që promovon potencialin e tyre sot, e që nxit në ta vetëbesimin e nevojshëm për t'u bërë anëtarë të vetëmjaftueshëm e të dobishëm të shoqërisë nesër, është një investim i vlerë i cili ka nevojë për përforsim të vazhdueshëm. Ndaj besoj që përpjekjet e deritanishme për të hartuar një kuadër ligjor në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare mbi të drejtat që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave si dhe përkujdesjen e veçantë të fëmijës, janë një fillim e vazhdim i mirë, por i pamjaftueshëm, për sa kohë që standardet aktuale të trajtimit në këto qendra rezidenciale a ditore nuk janë ato të kërkuarat apo të pritshmet. Ne ende diskutojmë mbi raste flagrante të përdorimit të dhunës fizike e psikologjike në këto institucione, ndërkohë që ajo çfarë do të duhej të kishim ofruar do të ishte një sistem i mirë organizuar përkujdesjeje alternative, ku shteti do të mundësonte struktura me të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, financiare, e materiale, të afta për fuqizuar familjet e për të ofruar shërbime mbështetëse sociale.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të vazhdojë të punojë për të garantuar mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të fëmijëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, duke u udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë. Krahas monitorimit të vazhdueshëm të të gjitha institucioneve publike ku trajtohen fëmijët rezidentë e ditorë me qëllim jo vetëm vlerësimin e nivelit të respektimit të drejtave të tyre në këto institucione, por edhe parandalimin e shkeljeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të trajtimit të tyre, ne do të vijojmë të punojmë për të promovuar respektimin e vazhdueshëm të të drejtave të fëmijëve, për të nxitur garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin të cilësisë së tyre të jetës.

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

PASQYRA E LËNDËS:

1. Hyrje.....	fq. 5
2. Metodologjia.....	fq. 6
3. Baza Ligjore për Mbrojtjen e Fëmijëve.....	fq. 7
3.1 Legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar.....	fq. 7
3.2 Standardet e Shërbimeve Shoqërore.....	fq. 13
3.3 Cilët janë autoritetet e inspektimit të Shërbimeve Shoqërore?.....	fq. 14
3.4 Drejt decentralizimit të Shërbimeve Shoqërore.....	fq. 16
4. Problematikat e Konstatuara nga Avokati i Popullit gjatë Vitit 2016 nga Inspektimet e kryera në 9 Institucionet Rezidenciale Publike të Përkujdesit për Fëmijët.....	fq. 19
4.1 Përmbledhje problematikash të konstatuara.....	fq. 20
5. Shtëpia e Foshnjës Lulet e Vogla”, Korçë.....	fq. 22
6. Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç, Vlorë.....	fq. 28
7. Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç “Hana dhe Rozafa”, Tiranë.....	fq. 34
8. Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë.....	fq. 39
9. Shtëpia e Fëmijës Shkollor 6-18 vjeç, Sarandë.....	fq. 47
10. Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç, Durrës.....	fq. 52
11. Shtëpia e foshnjës 0-6 vjeç, Shkodër.....	fq. 57
12. Shtëpia e Fëmijës parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër.....	fq. 62
13. Shtëpia e Fëmijës Shkollor 6-18 vjeç, Shkodër.....	fq. 68
14. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve.....	fq. 77
15. Konkluzione dhe Rekomandime.....	fq. 77

1. HYRJE

Ky raport i veçantë i Avokatit të Popullit mbi nivelin e respektimit të të drejtave të fëmijëve në institucionet publike të përkujdesjes rezidenciale për fëmijët në shtëpi fëmije dhe shtëpi foshnje në Shqipëri, është produkt i punës tre mujore të një grupi multidisiplinar ndër sektorial ekspertësh nga Seksioni i Fëmijëve, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe Seksioni i Përgjithshëm, pranë këtij institucioni. Raporti përmban informacion të detajuar mbi mënyrën e trajtimit, kushtet materiale, strukturat organizative dhe personelin që punon në këto institucione, si dhe kujdesin shëndetësor e psiko-social të ofruar në to.

Për pasjen e një panorame sa më të plotë, në zbatim të urdhrit të Avokatit të Popullit nr. 93, datë 11.04.2016, grupi multidisiplinar i institucionit të Avokatit të Popullit inspektoi 9 qendra rezidenciale të mbajtës së fëmijëve jetim biologjik e social, prej të cilave 6 shtëpi fëmije parashkollore (0-6 vjeç) në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Korçë (ditore dhe rezidenciale), dhe 3 shtëpi fëmije shkollore (6-18 vjeç) në Tiranë, Sarandë dhe Shkodër;

Nga inspektimet e bëra në këto qendra rezulton se ndaj fëmijëve të institucionalizuar në këto institucione ka pasur raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike nga stafi dhe zyrtarët përgjegjës për mirëqenien e tyre.

Ndaj nga ana e institucioneve përgjegjëse qeveritare qendrore dhe vendore është e nevojshme kryerja e reformave institucionale për përmirësimin e situatës së trajtimit të fëmijëve që rriten nën mbrojtjen e shtetit. Është domosdoshmëri që në këtë proces të përfshihen edhe organizata të tjera të shoqërisë civile që kanë mjaftueshëm eksperiencë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Më e rëndësishmja, rezultatet dhe rekomandimet që pasojnë këtë raport mund të shërbejnë si një udhëzues për zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës të veprimit kombëtar për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në institucione të kujdesit rezidencial.

Institucioni i Avokatit të Popullit i është veçanërisht mirënjohës fëmijëve që morën pjesë në intervistat konfidenciale me ekspertët e institucionit, por edhe ndaj drejtuesve dhe stafit gjatë kohës së kryerjes së inspektimeve.

2. METODOLOGJIA

Gjatë çdo inspektimi në institucionet rezidenciale të përkujdesjes për fëmijët, grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga pesë juristë, një mjeke psikiatre dhe një psikologe klinike, si metodologji pune ka përdorur:

- Zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtyre institucioneve, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve. Më tej grupi multidisiplinar ka kryer monitorimin e detajuar të të gjitha fushave përkatëse të përcaktuara në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për fëmijët në Institucionet Rezidenciale”
- Kryerjen e intervistave konfidenciale dhe në grup me fëmijë të grup moshave të ndryshme, me qëllim krijimin e një perceptimi sa më të plotë të trajtimit të fëmijëve në këto qendra.
- Inspektimin në vend të kushteve materiale në të cilat jetonin fëmijët, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, dushet, pajisjet e hotelerisë, veshmbathjet, ushqimin, kuzhinën, lavanterinë, higjienën, lagështirën, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme të këtyre institucioneve etj.
- Kontrollin në mënyrë të detajuar të planeve individuale të kujdesit shëndetësor ku përfshihen kontrollet periodike mjekësore (kontrolli i syve, dentar, alergjitë e ndryshme, etj.), vaksinimi, zhvillimi psiko-motor i fëmijëve, si dhe dokumentacioni përkatës i mbajtur nga stafi i sektorit shëndetësor (kartelat mjekësore, kartelat e vaksinimit, regjistrat përkatës etj.
- Kontrollin e dosjeve të zhvillimit psiko-social për çdo fëmijë, raportet e vlerësimit të nevojave dhe ecurisë, aktivitetet rekreative, etj.
- Kontrollin e mënyrës së rekrutimit të stafit të këtyre institucioneve, arsimimin, trajnimet e tyre për zhvillimet profesionale, etj.

Në përfundim të çdo inspektimi, grupi monitorues i Institucionit të Avokatit të Popullit ka kryer biseda përmblylëse me drejtuesit e institucioneve, përgjatë të cilave ka adresuar problematikat e ndryshme të hasura gjatë inspektimeve dhe ka lënë rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuara për çdo qendër në këtë raport të veçantë.

3. KUADRI LIGJOR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

3.1 Legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar

Konventa e OKB “Për të Drejtat e Fëmijës” ka përcaktuar në nenin 1 të saj se “Fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç”. Pra fëmijët përbëjnë në vetvete një grupim social. Legjislacioni shqiptar ka përcaktuar se kush janë përfitues të ndihmës dhe të shërbimit shoqëror, si dhe llojet e shërbimeve të ofruara për kategorinë e personave në nevojë. Njohja e legjislacionit, e shërbimeve sociale të cilat ofrohen si dhe standardet për ofruesit e shërbimeve shoqërore shërben për ndërgjegjësimin dhe orientimin e kërkesave kundrejt ushtruesve të pushtetit, qoftë ky pushtet vendor apo qendror.

Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 54 të saj ka përcaktuar se “fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja, kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa. Çdo fëmijë, ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal”. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi e të atyre pa kujdes prindëror në veçanti. Ajo sanksionon detyrimin e shtetit për të siguruar kujdesin dhe ndihmën për fëmijët pa kujdes prindëror përgjatë gjithë procesit të rritjes, zhvillimit dhe arsimimit të tyre.¹

Kodi i Familjes ka përcaktuar detyrimet institucionale të shtetit për fëmijët pa kujdes prindëror dhe mënyrën se si duhet të trajtohen ato. Në Kodin e Familjes “fëmijë pa kujdes prindëror” konsiderohen të gjithë këta fëmijë:

- prindërit e të cilëve kanë vdekur,
- prindërit e të cilëve janë shpallur të panjohur,
- prindërit e të cilëve janë shpallur të humbur,
- që janë braktisur nga prindërit,
- prindërit e të cilëve janë privuar nga e drejta e tyre prindërore në bazë të një vendimi përfundimtar gjykate.

Me vendim gjykate, vendoset për formën e kujdesit ndaj fëmijës:

- familje me lidhje gjaku, ku njëri nga anëtarët e familjes do të jetë kujdestari;
- një familje e huaj
- një person që caktohet si kujdestar
- një familje që caktohet si kujdestare
- një institucion i përkujdesit social

¹ Neni 59/e

Gjykata merr parasysh dhe rekomandimin e drejtorisë për ndihmën sociale dhe të shërbimeve sociale në bashkinë përkatëse e çdo informacion tjetër mbi zhvillimin dhe personalitetin e fëmijës, duke pasur në qendër të vëmendjes se cila formë kujdesi do të ishte më e mira për fëmijën. “Kërkesa për vendosjen e kujdestarisë i paraqitet gjykatës nga të afërmit e fëmijës së mitur dhe nga cilido që merr njoftimin për mbetjen e fëmijës pa prindër, për lindjen e një fëmije me prindër të panjohur dhe për çdo rrethanë tjetër që ligji kërkon vendosjen e kujdestarisë si dhe ushtrimin e kësaj të drejte nga vetë i mituri kur ai ka mbushur moshën 16 vjeç”². Gjithashtu, sipas nenit 356/1 të KPrCivile “gjykata, përpara se të procedojë për emërimin e kujdestarit, duhet të pyesë edhe të miturin, kur ai ka mbushur moshën 10 vjeç”. Legjislacioni shqiptar i përkufizon jetimët si persona në moshat nga 0 deri në 25 vjeç të cilët: (I) kanë lindur jashtë martesë; (II) nuk kanë prindër të gjallë; (III) janë deklaruar jetimë me vendim gjyqi; ose (IV) janë braktisur nga prindër të pidentifikuar. Kjo është kategoria e parë e fëmijëve të destinuar të rriten pa kujdes prindëror.

Ligji nr. 8153, datë 31 tetor 1996, “Mbi statusin e jetimit” përcakton kriteret e vendosjes së fëmijëve në institucione të përkujdesit social. Ky status u jepet disa kategorive fëmijësh siç përkufizohen në Kodin e Familjes, dhe jepet në Shërbimin Social Shtetëror. Sot synohet për një mbrojtje më efektive të të drejtave të fëmijëve pa kujdesin prindëror:

- Nxjerrja nga dyert e institucioneve, pra deinstitutionalizimi;
- Shërbime shoqërore që decentralizohen, pra rol më i madh i pushtetit vendor
- Ofrimi i shërbimesh të integruara
- Dhënia e këtyre shërbimeve në komunitet dhe në familje
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i burimeve të qeverisë qendrore me ato të pushtetit vendor dhe shoqërisë civile.

Legjislacioni ndërkombëtar synon të tregojë që kujdesi me bazë familjen duhet të prevalojë ndaj kujdesit rezidencial për fëmijët, dhe se përkujdesi alternativ duhet të përbëjë një masë mbrojtëse me karakter të përkohshëm. Disa nga standardet dhe parimet bazë ndërkombëtare për mbrojtjen e përkujdesin (rezidencial) e fëmijëve paraqiten në këto dokumente aq të rëndësishme të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës:

- *Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për të Drejtat e Fëmijës”*
- *Rekomandimi nr.5 i Këshillit të Evropës mbi të drejtat e fëmijëve në institucionet rezidenciale (2005)*
- *Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Përkujdesjen Alternative*

² Nenet 351/1 dhe 352 të Kodit të Procedurës Civile

- *Komenti nr.14 (2013) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara Mbi të drejtën e fëmijës për konsiderimin si parësor të interesit të tij më të mirë.*
- *Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi të drejtat e Fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale.*
- *Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Mbi të drejtat e fëmijëve dhe shërbimet sociale miqësore për fëmijët dhe familjet³*

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës e ka përcaktuar familjen si vendin më të përshtatshëm për rritjen e një fëmije, dhe prindërit janë (ose më mirë të themi *duhet të jenë*) mbrojtësit e parë të të drejtave të fëmijëve. Neni 7 i saj e jep përcaktimin e qartë të të drejtës që ka fëmija për t'u rritur në familjen e tij dhe me prindërit e tij. E po ashtu nenet 5 dhe 18 të këtij dokumenti ndërkombëtar përmbajnë parimet e përgjegjësisë prindërore si dhe mënyrën se si duhen mbështetur familjet në mirërritjen e fëmijëve që kanë⁴. Në nenin 9 i njihet e drejta e fëmijës për të mos u ndarë nga prindërit kundër dëshirës së tyre, përveç rastit kur kjo ndarje është e domosdoshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës. Ky vendim mund të jetë i nevojshëm në raste të veçanta, si ai kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija. *“Shtetet duhet të angazhohen të marrin të gjitha masat legislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë”⁵* Ndaj, asnjë shkurtim apo kufizim buxhetesh nuk mund ta përlligjë shkeljen e të drejtave civile, e aq më tepër të jetë shkak për diskriminimin apo shkeljen e të drejtave të fëmijëve.

Në çdo vendimmarrje prioritet duhet të kenë grupet më të marxhinalizuara të fëmijëve. **Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve të Fëmijëve**, anëtar i të cilit është edhe Avokati i Popullit, në deklaratën e tij “Kundër dhunës ndaj fëmijëve”⁶ ritheksoi me forcë që *“Dhuna ndaj fëmijëve është e pa tolerueshme, çdo akt dhune ndaj fëmijëve mund të parandalohet”*.

Edhe **Karta e BE Mbi të drejtat themelore**, në nenin 24/2 ka përcaktuar se: *“Çdo fëmijë duhet të ketë të drejtën e marrëdhënies vetjake rregullisht dhe drejtpërdrejtë*

³ Council of Europe Rec (2011)12; 16.11.2011.

⁴ Neni 18 i KDF “1.Shtetet Palë përpiqen me të gjitha mundësitë, për të siguruar njohjen e parimit, sipas të cilit të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkët për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës e kanë prindërit, ose sipas rastit, përfaqësuesit e tij ligjorë. Ata duhet të udhëhiqen, në radhë të parë, nga interesi më i lartë i fëmijës. 2. Për të garantuar dhe zhvilluar të drejtat e përmendura në këtë Konventë, Shtetet Palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që u bie atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit për fëmijët. 3. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar fëmijëve, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune, të drejtën të përfitojnë nga shërbimet dhe lehtësitë e kujdesit për fëmijët, për të cilat janë ngritur”.

⁵ Neni 4 i Konventës “Për të drejtat e Fëmijëve”.

⁶ Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e ENOC, 24 Shtator 2015, Hagë-Hollandë.

me të dy prindërit e tij, përveç rasteve kur kjo bie në kundërshtim me interesin e tij/të saj”.

Çdo fëmijë ka të drejtën e respektimit të jetës së tij familjare, e drejtë kjo e njohur nga neni 8 i **Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**. Shpesh është e vështirë të vlerësosh çka është më e mira për një fëmijë: Të sigurosh që në respekt të jetës së tij në familje, ai/ajo të qëndrojë pranë saj, apo ta mbrosh atë nga keqtrajtimet që ajo i shkakton. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjykuar një numër të konsiderueshëm rastesh (si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe thelbësore) të vendosjes së fëmijëve nën përkujdesin alternativ⁷. Po ashtu edhe Karta Sociale Evropiane ka përcaktuar që Shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen dhe ndihmën e posaçme për fëmijët dhe të rinjtë të cilët përkohësisht apo në mënyrë të përhershme janë të përjashtuar nga kujdesi prindëror⁸.

Ndërkohë që **Udhëzimet për Përkujdesjen Alternative ndaj Fëmijëve**⁹ të miratuar me Rezolutën përkatëse të Kombeve të Bashkuara përshkruajnë nevojën për politika dhe praktika të duhura në lidhje me dy parime bazë: domosdoshmërinë dhe përshtatshmërinë. Në thelb të domosdoshmërisë qëndron dëshira për të mbështetur fëmijët, që ata të qëndrojnë në familjen e tyre dhe t’u ofrohet përkujdesje nga kjo e fundit. Largimi i çdo fëmije nga familja e tij/saj duhet konsideruar si një masë e fundit, dhe përpara marrjes së një vendimi të tillë, është e nevojshme kryerja e një vlerësimi rigoroz me pjesëmarrjen e të gjithë palëve. Për sa i përket përshtatshmërisë, Udhëzimet për Përkujdesjen Alternative ndaj Fëmijëve përcaktojnë një sërë opsionesh të përshtatshme të përkujdesjes alternative. Çdo fëmijë në nevojë për përkujdesje alternative ka kërkesa specifike, për shembull, që kanë lidhje me përkujdesjen afatshkurtër apo afatgjatë apo qëndrimin së bashku të vëllezërve dhe motrave. Opsioni i përzgjedhur i përkujdesjes duhet t’i përshtatet nevojave individuale të fëmijës. Përshtatshmëria e vendosjes nën përkujdesje duhet të rishikohet rregullisht për të vlerësuar nevojën në vazhdimësi të ofrimit të përkujdesjes alternative dhe realizimit të një ribashkimi të mundshëm me familjen. Ato janë skicuar për t’u përhapur gjerësisht në të gjithë sektorët të cilët merren drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë me çështjet që kanë të bëjnë me përkujdesjen alternative, dhe synojnë në mënyrë të veçantë:

- Të mbështesin përpjekjet për të mbajtur apo rikthyer fëmijët nën përkujdesjen e familjes së tyre ose, për të gjetur, në mungesë të tyre, një zgjidhje tjetër të përshtatshme dhe të përhershme;

⁷Për shembull çështja *Āallová dhe Āalla kundër Çekisë* (me nr. 23848/04, 2006-vendosja e fëmijës në kujdestari si shkak i kushteve jo të përshtatshme të banimit)

⁸Neni 17 (1) c.

⁹http://ëëë.unicef.org/protection/alternative_care_Guidelines-English.pdf

- Të sigurojnë që ndërsa kërkohen zgjidhje të tilla të përhershme, ose në rastet kur ato nuk janë të mundshme ose nuk janë në interesin më të mirë të fëmijës, të identifikohen forma më të përshtatshme të përkujdesjes alternative *me kusht që të nxisin zhvillimin e plotë dhe harmonik të tij/saj*;
- Të ndihmojnë dhe inkurajojnë Qeveritë që të zbatojnë sa më mirë përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre në këtë kuadër, duke pasur parasysh kushtet ekonomike, sociale dhe kulturore në secilin Shtet, dhe:
- Të drejtojnë politikën, vendimet dhe aktivitetet e të gjithë atyre që janë të përfshirë në mbrojtjen sociale dhe mirëqenien e fëmijëve si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat, përfshi dhe shoqërinë civile.

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara të përkujdesit alternativ për fëmijët përmbajnë si parime bazë:

- Mbështetjen për mjedisin familjar
- Vendosjen e fëmijës në institucion si masën e fundit, dhe për një periudhë sa më të shkurtër të mundshme,
- Respektimin e të gjitha të drejtave për të gjithë fëmijët gjatë qëndrimit në institucion,
- Mbrojtjen e nevojshme ligjore,
- Nevojën për standarde cilësore,
- Mekanizmin e ankimit,
- Deinstitutionalizimin.

Në mesazhin që Përfaqësuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara kundër dhunës ndaj fëmijëve paraqiste në Konferencën Vjetore të Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijët¹⁰ theksonte se *“Zyrat e Ombudsmanëve e kanë mandatin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna “duke ndihmuar në thyerjen e heshtjes rreth situatave të dhunës, duke ndikuar për përmirësime ligjore dhe reforma në politika, duke ndërmarrë studime, dhe mbi të gjitha duke krijuar institucione të cilave fëmijët u besojnë dhe u qasen atyre”*. E po ashtu ajo ka nënvizuar se *“rreziku i dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e përkujdesit rezidencial është 6 herë më e lartë sesa e fëmijëve në forma të tjera përkujdesi”*.

Dhe vlera e shtuar e punës së Ombudsmanëve në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në institucionet e përkujdesit rezidencial¹¹ është

- o Veprimtaria e ndërthurur individuale dhe strukturore
- o Qasja në të drejtat e fëmijëve
- o Mbikëqyrës (ëatchdog) i fëmijëve vulnerabël;

¹⁰ Varshavë, 14-16/09/2011 “Respektimi i të drejtave të fëmijëve në përkujdes institucionale”; Message from Marta Santos Pais-ENOC Conference”, ëëë.ombudsnet.org

¹¹ E njëjta “Role of Ombudsman”

- Status i pavarur
- Fushata ndërgjegjësimi
- Monitorimi dhe raportim
- Informim i Komitetit të Gjenevës për të drejtat e Fëmijës.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës me rekomandimin e saj¹² Për dhënien fund varfërisë ndaj fëmijëve në Evropë i bën thirrje shtimit të vëmendjes ndaj varfërisë së fëmijëve dhe pjesëmarrjes së tyre në shërbimet sociale. Në Raportin e vlerësimit të Strategjisë së Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve¹³(2012-2015) përcaktohet se: “Eshtë bërë progres gjatë këtyre viteve (periudhës së raportimit) në zbatimin e standardeve të të drejtave të fëmijës, duke mbledhur pjesëzat e një puzzle (formueseje) së bashku. Megjithatë ka mjaft sfida të dukshme, dhe këto adresohen në Strategjinë e Re të Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve.”

Strategjia e re e Këshillit të Evropës Mbi të Drejtat e Fëmijës (2016-2021) përbën të tretën Strategji të Këshillit të Evropës për të drejtat e fëmijëve. Duke pasur në vëmendje edhe Konventën e OKB Për të Drejtat e Fëmijës, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe standardet e tjera ligjore të Këshillit të Evropës, kjo Strategji ka identifikuar pesë prioritetet për 47 shtetet anëtare, ku bën pjesë edhe Shqipëria, për të garantuar të drejtat e fëmijës:

- 1-Mundësi të barabarta
- 2-Pjesëmarrja e fëmijëve
- 3-Një jetë pa dhunë
- 4-Drejtësia miqësore për fëmijët
- 5-Të drejtat e fëmijëve në mjedisin digjital

Me gjithë këto parashikime, realiteti paraqitet i ndryshëm: fëmijë të keqtrajtuar me mangësi ekonomike e kushte të vështira jetese të cilat çojnë shpesh në domosdoshmërinë e largimit të fëmijës nga ambienti familjar dhe nevojën për kujdesin shtetëror. Kjo zhvendosje e fëmijës gjithmonë duhet t’i shërbejë dhe të jetë për interesin e tij më të mirë, dhe fëmija në mjaft raste nga subjekt mbrojtjeje, nuk është dhe “aktori” real, pra mendimi i tij shpesh nuk merret parasysh.

Strategjia bën thirrje për rritjen e informimit të veprimtarisë së institucioneve kombëtare përgjegjëse për monitorimin e përputhshmërisë me të drejtat e fëmijës, përkatësisht Ombudspersonët për fëmijë dhe institucione të tjera kombëtare të të drejtave të njeriut duke u fokusuar në të drejtat e fëmijëve. Strategjia ka përcaktuar

¹² Parliamentary Assembly Report Doc. 13458 (2014), Ending child poverty in Europe.

¹³ www.rm.coe.int, faqe 31.

edhe pritshmëritë për secilën nga pesë fushat prioritare, dhe performanca se sa janë realizuar objektivat do të kryhet në periudha të rregullta kohore. Në të njëjtën rrugëtim duhet të ecë edhe përshkrimi i pritshmërive të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, duke hartuar Strategjinë Kombëtare me detyra të mirë përcaktuara për çdo aktor; afatet kohore si dhe buxhetet përkatëse për secilën fushë prioritare. Fakt është që viti 2016 po mbyll gjysmën e tij, dhe ende nuk kemi një Strategji të re Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

3.2 STANDARDET E SHËRBIMEVE SHOQËRORE.

Institucionet rezidenciale publike të përkujdesit rezidencial për fëmijë funksionojnë në bazë të standardeve dhe procedurave të bazuara sipas politikave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, sipas legjislacionit për sistemimin e mbrojtjes shoqërore dhe udhëzimeve përkatëse.

- Ligji Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, I ndryshuar
- Ligji Nr. 10347 datë 04.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”
- VKM Nr. 658 datë 17.10.2005 “Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore”
- VKM Nr 659 datë 17.10.2005 “Për Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Institucionet Rezidenciale”
- VKM Nr. 839 datë 03.12.2014 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin 425 datë 27.06.2012 “Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim”.

Në Ligjin “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” përcaktohen “parimet bazë, mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore” të cilat janë:

- a) respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit;*
- b) universaliteti;*
- c) barazia e mundësive;*
- d) e drejta për të përfituar;*
- e) partneriteti;*
- f) transparencja dhe paanshmëria;*
- g) decentralizimi;*
- h) pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit;*
- i) mosdiskriminimi;*
- j) karakteri subvencionues”.*

Ligji pasqyron rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për çdo shtetas që bëhet përfitues i shërbimeve shoqërore, ndërsa vendosja e standardeve për shërbimet shoqërore përbën një mënyrë për t'i zbatuar këto parime në praktikë. Në thelb, standardet¹⁴ përfaqësojnë një nivel të përbashkët të funksionimit dhe të kryerjes së veprimtarisë, që kërkohet të arrihet nga të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore. Standardet janë parime të përgjithshme që shërbejnë për të siguruar cilësinë e shërbimeve shoqërore.

Standardet janë të rëndësishme:

Së pari, për të garantuar dhe për të zhvilluar më tej të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare.

Së dyti, për të matur dhe ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shoqërore të ofruara për përfituesit.

Së treti, për të lehtësuar proceset decentralizuese që ngarkojnë me përgjegjësi më të mëdha autoritetet vendore në lidhje me shërbimet shoqërore.

Pjesë e mbrojtjes shoqërore për zbutjen e pasojave të varfërisë, është dhe ndihma ekonomike, për familjet pa të ardhura, me të ardhura të pamjaftueshme jetese dhe për ato familje me më shumë se dy fëmijë të lindur njëherësh. Në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar", personat që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror pranohen në institucionet rezidenciale publike pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shërbimet shoqërore publike përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen për grupet në nevojë në institucionet rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore. Në kuadër të decentralizimit bashkitë administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individët, që janë banorë të atij qyteti.

Parimet bazë mbi të cilat funksionon skema e ndihmës dhe e shërbimeve shoqërore janë: *respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit, universaliteti, barazia e mundësive, e drejta për të përfituar, partneriteti, pavarësia, integriteti shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit, mosdiskriminimi dhe karakteri subvencionues*. Sipas këtij ligji, me *shërbime shoqërore* kuptohet: tërësia e shërbimeve që u ofrohet individëve dhe grupeve në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të përballojnë me burimet që kanë, nevojat e tyre jetësore për ruajtjen, zhvillimin dhe rehabilitimin e mundësive individuale, për të kapërcyer nevojat emergjente ose kronike. Shërbimet e përkujdesit shoqëror, sipas mënyrës së organizimit dhe të funksionimit, janë:

¹⁴ VKM Nr.658, datë .17.10.2005 "Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore"

- shërbime të përkujdesit rezidencial;
- shërbime të përkujdesit komunitar.

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë edhe fëmijët e të rinjtë deri në moshën 25 vjeç. Fëmijët e mitur, janë përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve shoqërore të kategorizuara më sipër. Ligji pasqyron rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për çdo shtetas që bëhet përfitues i shërbimeve shoqërore, duke përfshirë në kategorinë e përfituesve edhe të miturit, si përfitues të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë. Përfitues të ndihmës ekonomike janë: familjet në nevojë, jetimët nën 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari, prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, e që u përkasin familjeve në nevojë.

Krahas vendosjes së Standardeve të Shërbimeve Shoqërore në Shqipëri, janë hartuar edhe **standarde specifike për shërbime specifike** që ofrohen për grupe të veçanta përfituesish, ku padyshim një vend mjaft të rëndësishëm zënë edhe **fëmijët**. Ato janë “Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror për Fëmijët në Institucionet Rezidenciale”¹⁵.

3.3 CILËT JANË AUTORITETET E INSPEKTIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE?

Bazuar në Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i ndryshuar; VKM nr. 512 datë 31.05.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të shërbimeve shoqërore”; VKM nr. 658 datë 17.10.2005 “Për Standardet e Shërbimeve Shoqërore, kryhen inspektime në këto institucione edhe nga **Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore**.

Mbikëqyrja e zbatimit të shërbimeve shoqërore dhe standardeve të tyre është përgjegjësi e Shërbimit Social Shtetëror dhe përfshin edhe 12 zyrat rajonale në të gjitha qarqet e vendit. Vlerësimet periodike shërbejnë për të shpërndarë praktikat më të mira, të cilat ekzistojnë në kujdesin e përfituesve të shërbimeve shoqërore. Për të bërë këtë, raportet e inspektimit rishikohen në nivelin qendror dhe shihen si një shkëmbim eksperience për të përmirësuar zhvillimin e standardeve. Ndaj, inspektimi kuptohet më shumë si ndihmë për ofruesit e shërbimit dhe si një mjet për identifikimin e shërbimeve cilësore, të cilat mund të shërbejnë si model për rajonet e tjera. Raportet periodike të inspektimit sigurojnë që pushteti vendor ka informacionin e nevojshëm për të identifikuar mangësitë në shërbimet sociale dhe

¹⁵ VKM Nr.659, datë 17.10. 2005 “Për Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”

të plotësojë detyrimet që rrjedhin nga politika e shërbimeve sociale. Raportet e inspektimit në nivel kombëtar, lehtësojnë planifikimin dhe dialogun midis sektorit publik dhe privat, që janë aktorët kryesorë në sistemin e kujdesit të përfituesve të shërbimeve shoqërore në institucionet e Ofruesve të shërbimit. Parimisht rezultatet e inspektimeve duhet të çojnë në përmirësimin e shërbimeve në nivel kombëtar dhe shpërndarjen më të mirë të tyre sipas nevojave lokale.

Shërbimi Social Shtetëror¹⁶ ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për 28 Institucione të Përkujdesit Shoqëror, 12 Zyra Rajonale, Administrata Qendrore e Shërbimit Social Shtetëror, si dhe 61 njësi administrative të qeverisjes vendore. Janë kryer 54 monitorime të Qendrave të përkujdesit (jo vetëm për fëmijët, por edhe për të moshuarit dhe PAK) nga SHSSH gjatë 2015. Pas ngjarjes së **dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve nga disa punonjës të stafit në Shtëpinë e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër**, nga SHSSH:

- a. U hartua dhe u shpërnda urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të SHSSH për zbatimin e procedurave të politikave të mbrojtjes së fëmijëve sipas standardeve.
- b. U hartua dhe u shpërnda Kodit i Sjelljes i cili u nënshkrua nga të gjithë punonjësit e institucionit.
- c. Në zbatim të urdhrimit të Ministrit nr. 177 datë 13.07.2015 “Për monitorimin dhe vlerësimin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë në bashkëpunim me ISHPSHSH u krye monitorim në të gjithë IPSH të fëmijëve lidhur procedurat e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi”¹⁷.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është organ i specializuar i pushtetit ekzekutiv për mbrojtjen dhe zbatimin e përpiktë të legjislacionit të punës në fushën e marrëdhënieve të punës dhe të mbrojtjes sociale. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është strukturë e ekzekutivit, organ i specializuar i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që *ka për mision zbatimin e përpiktë e nga të gjithë, të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e marrëdhënieve të punës dhe çështjeve sociale është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave si strukturë e Ministrisë së Mirëqenies.*

Vendosja e fëmijëve dhe hapat që ndërmerren për institucionalizimin e tij bazohen në Ligjin nr. 10399, datë 17.03.2011 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, VKM nr. 425, datë . 27.06.2012 “Për Përcaktimin e Kritereve dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Pranimin e Personave në Institucionet Rezidenciale, Publike dhe Jopublike, të Përkujdesjes Shoqërore” i ndryshuar me VKM nr. 839 datë 3.12.2014, si dhe

¹⁶ www.sociale.gov.al/ministria/institucionet-ne-varesi

¹⁷ Faqe 10, raporti 2015 i SHSSH.

Udhëzimin nr. 6, datë 21.05.2014 “Për procedurat e sistemimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror”. Shërbimet sociale për fëmijët kanë për qëllim mbrojtjen dhe sistemimin në institucione të përkujdesit shoqëror të fëmijëve në nevojë, si fëmijët jetimë, socialë dhe biologjikë deri në moshën 18 vjeç.

Procedura që ndiqet: Kontakti me personelin e Zyrës Rajonale të Shërbimeve Sociale në 12 qarqet e vendit për problematikën që paraqitet. Nismën për dërgimin e fëmijës në institucionet e përkujdesjes shoqërore e kanë:

- Të dy prindërit ose njëri prind kur tjetri nuk jeton;
- Kujdestari i fëmijës;
- Titullari i institucionit shëndetësor;
- Policia e Shtetit;
- Seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore, në nivel vendor;
- Njësia e të drejtave të fëmijëve, në nivel qarku;
- Njësia e mbrojtjes së fëmijëve, në nivel bashkie;
- Institucioni i shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, i mëparshëm, kur fëmija ka mbushur moshën përkatëse;
- Organizata jofitimprurëse të licencuara, të cilat ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore për fëmijët;
- Zyrat Rajonale të shërbimeve sociale.

3.4 DREJT DECENTRALIZIMIT TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Para viteve '90, si në mjaft vende ish-komuniste, vendi ynë, kishte institucionalizuar shumë shërbimet ndaj këtyre grupeve në nevojë të popullsisë, duke i kthyer ata thjesht në marrës të tyre dhe jo në ndërveprues.

Deinstitutionalizimi synon ta ndryshojë këtë situatë, duke theksuar kontributet që mund të japin grupimet në nevojë në shoqëri nëpërmjet bashkëveprimit interaktiv të tyre. Proceset decentralizuese, sidomos për Shqipërinë, janë parë si të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve publike në nivelet dhe standardet e kërkuara nga BE. Pjesë e shërbimeve publike janë dhe shërbimet sociale ku përfitues janë jetimët. Procesi decentralizues si një nga rezultatet më të rëndësishme ka sjelljen e qytetarit më afër vendimmarrjes, duke synuar pa dyshim përmirësimin cilësor të jetesës së shtetasve. Transferimi i burimeve dhe i vendimmarrjes është në funksion të përmirësimit të jetesës së popullsisë.

Megjithatë, zbatimi i politikave decentralizuese shpesh ofron mangësi e boshllëqe pasi autoritetet vendore përballen me përgjegjësi të reja, por nuk janë të pajisura *as me burimet e kërkuara* për të realizuar mirë proceset decentralizuese (duke përfshirë këtu dhe stafin e kualifikuar) *dhe as me fuqitë e duhura* vendimmarrëse. Po ashtu edhe institucionet në qeverisjen qendrore, përgjegjëse për proceset decentralizuese, ndodh të mos i kryejnë mirë funksionet administrative dhe mbikëqyrëse, aq të nevojshme në rezultatin përfundimtar të decentralizimit. Decentralizimi i shërbimeve sociale në Shqipëri duhet ta detyrojë pushtetin vendor që të hartojë politika të qarta me fokus fëmijët. Mbrojtja e fëmijës nuk konsiderohet vetëm si një veprim parandalues, por si një veprim që përqendrohet gjithashtu në ofrimin e shërbimeve deri në momentin që fëmija nuk është më në rrezik.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe e Rinisë është autoriteti përgjegjës për:

- hartimin e politikave,
- legjislacionin,
- programimin e fondeve të NE-së për familjet dhe personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore,
- miratimin e standardeve të shërbimeve,
- licencimin e personave juridikë privatë që do të ofrojnë shërbime shoqërore etj.

Pra kemi një përqendrim të shumë funksioneve në “duart” e institucionit të qeverisë qendrore, duke lënë pak hapësira për një decentralizim të mirëfilltë në konceptin real të tij. Ndërkohë që është pikërisht pushteti vendor i cili njih më së miri nevojat sociale të komunitetit, dhe, në këtë këndvështrim, aktori me ndikimin më të madh për të realizuar strategji efektive.

Por në këtë kuadër, ekziston një hapësirë tolerance për marrjen parasysh të kërkesave të pushtetit vendor dhe kjo në kuadrin e proceseve decentralizuese, duke vlerësuar kështu rolin e aktorit ndërmjetës të të dy hallkave që është Shërbimi Social Shtetëror. Është pikërisht ky aktor i cili ka funksionin dhe përgjegjësinë e:

- a) zbatimit të politikave të hartuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe, gjithashtu,
- b) monitorimit me tendencën e realizimit sa më mirë të tyre.

Institucionalizimi i fëmijëve nuk është zgjidhja përfundimtare e reduktimit të varfërisë së tyre. Kalimi nga ish MPÇSSHB (sot Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë) në varësi të SHSSH, i disa qendrave rezidenciale në nivel kombëtar është realizuar bazuar në ligjet përkatëse¹⁸.

¹⁸ Ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore “ dhe të Ligjit nr.9464 datë 28.12.2005 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2006” si dhe VKM nr.336 datë 31.05.2006 “Për transferimin në pronësi disa bashkive të pronave,

Aktualisht Reforma e Shërbimeve Sociale në Shqipëri synon decentralizimin e shërbimeve shoqërore, deinstitucionalizimin e shërbimeve të ofruara në qendrat e përkujdesit rezidencial dhe të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror. Në zbatim të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar", personat që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror pranohen në institucionet rezidenciale publike pa pagesë, nëse familjet e tyre nuk kanë asnjë të ardhur. Shërbimet shoqërore publike përfshijnë shërbimet e përkujdesit shoqëror që ofrohen për grupet në nevojë në institucionet rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore. Në kuadër të decentralizimit janë procese nën progres, si: licencimi i siguruesve të shërbimeve publike, transferimi i institucioneve rezidenciale në njësitë e qeverisjes vendore dhe zhvendosje e mëtejshme nga institucionet rezidenciale në shërbimet familjare.

Aktualisht janë 9 (nëntë) institucione publike rezidenciale të përkujdesit shoqëror që trajtojnë fëmijë jetimë dhe jetimë socialë.

Kategoritë e fëmijëve që jetojnë, edukohen dhe trajtohen në institucionet e përkujdesit social, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 9355 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore" i ndryshuar, janë:

- Fëmijë jetimë biologjike, të cilët i kanë humbur të dy prindërit
- Fëmijë të braktisur që në lindje/jashtë martese
- Fëmijë nga familje me probleme sociale, kushte të vështira ekonomike (Prindër me paaftësi mendore dhe fizike dhe të sëmurë, vdekjes së një prindi, rimartesës ose largimit në emigracion të prindit tjetër; me Prindi/prindërit të burgosur apo familje një prindërore). Situata e vështirë ekonomike e familjes/prindit, është një faktor që ka peshë të konsiderueshme për vendosjen e fëmijëve në institucione.

Misioni kryesor i këtyre institucioneve është kthimi i fëmijëve në familjen biologjike ose gjetja e një familjeje kujdestare apo birësuese. Institucionet rezidenciale për fëmijë janë institucione të financuara nga buxheti i shtetit dhe donatorë të ndryshëm.

Shërbimi publik për fëmijët pa kujdes prindëror ofrohet në 9 Institucione të Përkujdesit Shoqëror, e konkretisht:

- 6 shtëpi fëmije parashkollore (0-6 vjeç) në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Korçë (ditore dhe rezidenciale);

të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe të VKM nr.60 datë 1.2.2006 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH".

- 3 shtëpi fëmije shkollore (6-18 vjeç) në Tiranë, Sarandë dhe Shkodër;

4. PROBLEMATIKAT E KONSTATUARA NGA AVOKATI I POPULLIT GJATË VITIT 2016 NGA INSPEKTIMET E KRYERA NË 9 INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE TË PËRKUJDESIT PËR FËMIJËT

Avokati i Popullit, si Institucion Kushtetues që ka për funksion mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të çdo individi nga veprimet ose mosveprimet e institucioneve publike, dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, e ka në fokus të tij promovimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve, jo vetëm nëpërmjet trajtimit të ankesave apo kërkesave, shqyrtimit të rasteve me iniciativë dhe inspektimeve, por edhe nëpërmjet hartimit të raporteve e studimeve mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në vendin tonë.

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të fëmijëve, si dhe në bazë të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: *"Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veçanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut". "Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise";*

Në përmbushje të misionit të tij, Institucioni i Avokatit të Popullit kreu vizita monitoruese në 9 institucionet publike rezidenciale të përkujdesit për fëmijët¹⁹. Përmbledhtazi problematikat e konstatuara pasqyrohen në vijim:

1. Organikat e miratuara me Urdhër të Kryeministrit, për institucionet e mësipërme rezidenciale nuk janë në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh.

¹⁹ Urdhri i Brendshëm i AP nr.93 datë 11.04.2016

- Në shumicën e institucioneve të monitoruara nga ana jonë, rezultoi se edhe pse dokumentacioni i disponuar në dosjet personale të stafit ishte përgjithësisht korrekt, me disa mangësi të vogla, (për institucionet që kanë varësi të dyfishtë, rekrutimi i stafit dhe procedurat e ndjekura nga bashkitë përkatëse përgjithësisht nuk janë transparente).
 - Më konkretisht ka mungesë stafi në psikolog, punonjës social, mjekë (janë me kohë të pjesshme), infermier, kujdestar, edukator por edhe mungesë në staf mbështetës si p.sh., kuzhinier, sanitar, punonjës lavanderie, detyra të cilat mbuloreshin nga stafi i shërbimit social. Pra përveç ngarkesës në punë, këtij stafi i ngarkohen detyra të tjera, gjë e cila lë mangësi të theksuara në përmbushjen e detyrës funksionale të tyre, shërbimi dhe përkujdesja ndaj fëmijëve.
 - Rojat e sigurisë ishin private, por nuk i mbulonin 24 orë këto institucione si rrjedhojë e mungesave në buxhet.
2. Varësia e dyfishtë e shtëpive të fëmijëve nga Bashkitë dhe nga Shërbimi Social Shtetëror (përveç Shtëpisë së fëmijës Hana dhe Rozafa 0-6 vjeç dhe Zyber Hallulli Tiranë si dhe Shtëpisë së Fëmijës Shkodër 3-6 vjeç të cilat kanë varësi vetëm nga SHSSH), krijon probleme të qenësishme si në ndarjen e detyrave ashtu edhe të përgjegjësive në lidhje me problematikat e hasura. Kjo do të shmangte kërkesat në dy drejtime (Bashki dhe SHSSH) për të njëjtin problem dhe objekt shtesë punonjësish.
 3. Përpjekjet për de institucionalizim të fëmijëve rezultojnë të pamjaftueshme për sa kohë që kjo detyrë u është ngarkuar stafeve sociale të shtëpive, ndërkohë që është pushteti vendor ai që duhet të punojë për fuqizimin ekonomik të familjeve që kanë fëmijët në këto institucione.
 4. Koha e kërkuar për të mundësuar procedurat e transferimit të fëmijëve që kanë mbushur moshën, në institucione të përshtatshme për ta, është mjaft e gjatë, duke sjellë edhe vonesa në transferimin e tyre si edhe vështirësi praktike të tilla si kuotat e pamjaftueshme ushqimore.
 - Nga dërgimi i kërkesave prej Institucioneve tek Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës pranë Bashkive, si dhe pranë Drejtorisë Rajonale e SHSSH e deri në marrjen e vendimit për fëmijën nga Komisioni i Vlerësimit të Nevojave (KNV) i Bashkisë, Qarkut apo SHSSH, kjo pasi në varësi të faktit se nga ka ardhur fëmija (Bashkia, Qarku apo SHSSH), aty kryhet edhe kërkesa për vendosjen e fëmijës në një tjetër institucion.
 5. Infrastruktura e pjesës dërrmuese të shtëpive është problematike.

- Ndërkohë që përpjekja është për t'i konceptuar ato si "shtëpiza familje", praktikisht nuk ka një ndarje specifike sipas grup moshave. Ambientet e përbashkëta, dhomat e akomodimit, dushet dhe tualetet shfrytëzohen nga fëmijë të grup moshave të ndryshme 6-18vjeç në kundërshtim me standardet.
 - Problemet me lagështirën, sistemet qendrore jofunksionale të ngrohjes, sistemi i mbrojtës kundër zjarrit jofunksionale (bombola kundër zjarrit të pa kolauduara), dhe mungesa e shkallëve të emergjencës në thuajse të gjitha shtëpitë, instalimet elektrike të ekspozuara (Vlorë), bombolat e pa kolauduara të gazit që përdoret për gatim (Durrës).
 - Mungesa e automjeteve për transportin e fëmijëve në kopshte, shkolla, qendra shëndetësore, apo qendra rekreative.
6. Shërbimi i shëndetësor është i pa unifikuar si përsa i përket burimeve njerëzore (mjekë, kryeinfermierë dhe infermierë) ashtu edhe vënies në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve nëpërmjet kartave të shëndetit me të cilat janë të pajisur të gjithë fëmijët. Në shumicën e shtëpive ky shërbim ofrohet nga mjekët e qendrave shëndetësore që mbulojnë lagjet ku janë të vendosura këto institucione, por shpenzimet për mjekimet e rekomanduara prej tyre nuk zbatoheshin me receta të rimbursueshme, por me një fond të posaçëm të pamjaftueshëm të vetë shtëpive. Përveç kalendarit të vaksinave i cili zbatohet në mënyrë rigorozë, kontrolli mjekësor i fëmijëve për zhvillimin psiko-motor, nevojat stomatologjike dhe ato okulistike nuk bëhet sipas standardeve të përcaktuara të periodicitetit. Mungesa e infermierëve në disa prej institucioneve ka sjellë si problematikë çështjen e administrimit të medikamenteve nga personel i paspecializuar, të cilët nuk e kanë detyrë funksionale (si p.sh., kujdestarë të turnit).
7. Shërbimi psiko-social i ofruar nga stafi përkatës linte për të dëshiruar, si rrjedhojë e stafit të pamjaftueshëm sipas specialiteteve, ngarkesave në punë, dhe mungesës së trajnimeve specifike sipas nevojave të fëmijëve, etj. Plotësimet në dosjet e fëmijëve ishin me informacione të përgjithshme atëherë kur nevojitej vlerësim i specializuar. Në çdo rast nevojitej punë në ekip multidisiplinar, gjë që ishte mjaft e vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Në mungesë të juristëve në institucione, përfaqësimi në gjykata për çështje të heqjes së të drejtës së prindërimit apo për procedura birësimi ngelej në ngarkesë të këtij sektori. Për më tepër edhe aty ku kishte psikologë, vlerësimet e këtyre të fundit nuk mund të përdreshin në gjykata ndonëse kërkoheshin prej këtyre të fundit, duke u faturuar shpenzimet për vlerësimet e psikologëve të tjerë vetë shtëpive.

8. Nga shqyrtimi i dosjeve të fëmijëve dhe veçanërisht i planeve individuale të kujdesit dhe raporteve për vlerësim të nevojave dhe ecurisë, nuk u konstatua të ishin specifikuar detaje mbi mënyrën e përfshirjes së fëmijës/ fëmijëve në aktivitete të ashtuquajtura “të aftësimit për jetën”, të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e fëmijëve për të jetuar në mënyrë të pavarur pas de institucionalizimit. Në këto kushte, përfshirja e planifikuar e fëmijëve në aktivitete të mirëmbajtjes së higjienës kolektive, qoftë kjo edhe për qëllime edukative, pa marrë në konsideratë moshën minimale të tyre, pa e rregulluar/ specifikuar në akte të brendshme, pa përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje, pa e parashikuar në planet individuale të kujdesit, dhe pa specifikuar se ky aktivitet nuk ndikon në kohën e nevojshme që i duhet fëmijëve për të kryer aktivitete të tjera primare për zhvillimin e tyre, rrezikon të bjerë ndesh me standardet ndërkombëtare të drejtave të fëmijëve mbi mbrojtjen nga shfrytëzimi për punë të detyruar. Mungesa e këtyre rregullimeve, përkrah mungesës së qëndrueshmërisë në përdorimin e masave ndëshkimore edukative dhe përforsimit negativ, rrezikon të prodhojë efekt të kundërt me atë që duhet të jetë edukimi i vazhdueshëm për aftësimin për jetesë të pavarur.
9. Nga intervistat konfidenciale me fëmijët dhe bisedat në grup me ta, rezultoi se në disa nga këto qendra ishte ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve nga ana e stafit që punon në këto qendra.

Konkretisht, për çdo institucion:

5. Shtëpia e Foshnjës Lulet e Vogla” KORÇE²⁰

Shtëpia e Foshnjës Korçë, me një kapacitet zyrtar prej 20 fëmijësh, në momentin e inspektimit kishte 13 fëmijë. Fëmijët ishin jetimë biologjikë e socialë të grup moshave 0-6 vjeç, nga të cilët 8 djem dhe 5 vajza. Moshën e tyre ishte: 2 fëmijë 6 vjeç; 3 fëmijë 5 vjeç; një fëmijë 4 vjeç; 3 fëmijë 3 vjeç; 1 fëmijë 2 vjeç dhe 1 fëmijë 1 vjeç; 1 fëmijë 5 muajsh dhe 1 fëmijë një muajsh.

Gjatë vitit 2015 kishin dalë nga institucioni 5 fëmijë, nga të cilët 4 ishin birësuar (dy brenda vendit dhe dy jashtë vendit) dhe një fëmijë i është rikthyer familjes biologjike. Pra gjatë këtij viti kanë hyrë në institucion 5 fëmijë dhe kanë dalë prej tij 5 fëmijë të tjerë.

²⁰ Inspektim i datës 12.05.2016

Varësia e Qendrës ishte e dyfishtë, nga Bashkia Korçë dhe Shërbimi Social Shtetëror. Nga Bashkia e Korçës paguheshin 4 punonjës²¹ (me kohë të plotë) e po ashtu nga Bashkia mbulohej edhe fondi për blerjen e naftës. Rregullorja e Qendrës është e miratuar me datë 7.06.2013 dhe e plotësuar më tej sipas problematikave. Problem konstatohet në shkresat e shumta që duheshin drejtuar për në Këshillin Bashkiak për të shtuar ndonjë punonjës ose për ndonjë fond të veçantë për Qendrën.

Problematike mbetej koha kur bëhej kërkesa nga Institucioni tek Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, pranë Bashkisë, si dhe tek Drejtoria Rajonale e SHSSH e deri në kohën e marrjes së vendimit për fëmijën nga Komisioni i Vlerësimit të Nevojave (KNV)-qoftë i Bashkisë, Qarkut apo SHSSH, e cila ishte relativisht e gjatë. Kjo pasi në varësi të faktit se nga ka ardhur fëmija (Bashkia, Qarku apo SHSSH), aty kryhej edhe kërkesa për vendosjen e fëmijës në një tjetër institucion, pra transferimi i fëmijës që ka mbushur 6 vjeç. Koha e gjatë e marrjes së vendimit nga Komisioni i Vlerësimit të Nevojave për transferimin e fëmijës në një tjetër institucion, pasi ka mbushur moshën 6 vjeç. Po ashtu problem paraqitej rasti kur një fëmijë pranohej në institucion nga SHSSH me urdhrin përkatës si rast emergjent.

Institucioni nuk kishte automjet, dhe domosdoshmëria e tij ishte evidente, duke konsideruar grup moshën e mitur që banon atje. Tetë fëmijë shkonin në kopsht në orarin 8.30-12. Zgjidhja mund të ishte, për shkak të kufizimeve buxhetore, caktimi i një automjeti për të treja qendrat e përkujdesit shoqëror publik në Korçë.

Trajtimi

Nga kontaktet me fëmijët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacioneve e intervistimi i stafit, nuk u konstatuan raste të përdorimit të dhunës fizike e psikologjike.

Fëmijëve iu mundësohej takimi i rregullisht me prindërit e të afërmit. Të afishuara në mure ishin deklarata e qëllimit, si dhe të drejtat e fëmijëve. Planet e punës ishin të hartuara për çdo muaj ku si objektiva ishin vendosur jo vetëm ndjekja në vijimësi e standardeve të shërbimeve për fëmijët, por edhe aktivitetet dhe integrimi i fëmijëve, takimet me prindërit, vizitat mjekësore për ta, etj..

Kuota ushqimore e fëmijëve 0-3 vjeç është 300 lekë dhe ajo për fëmijët 3-6 vjeç është 310 lekë. Nga institucioni kjo kuotë konsiderohej e mjaftueshme. Problematika shfaqej kur fëmijët kalonin moshën 6 vjeç, por vazhdonin të qëndronin në institucion deri në momentin e mundësisimit të transferimit.

²¹ Bazuar në Urdhrin nr.76 të datës 1.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Korçë "Për miratimin e strukturës të institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë Korçë"; tabela përmban 3 kujdestare.

Personeli dhe Organika

Personeli përbëhej nga 18 veta gjithsej nga të cilët: 1 drejtor; 1 përgjegjës i sektorit social, 8 kujdestare, 1 përgjegjës i sektorit administrativ, 3 punonjës administrate (sanitare dhe kuzhinierë); 3 kujdestarë të emëruar nga Bashkia e Korçës dhe një mjeke me kohë të pjesshme.

Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimin të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 infermier

1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Në institucion nuk kishte specialist psikolog. Punonjësja sociale ishte përpjekur ta plotësonte këtë mungesë sa i përket mbajtjes së dokumentacioneve dhe përpjekjeve drejtuar fondacioneve për të fuqizuar familjet, në mënyrë që të krijoheshin kushtet e rikthimit të të miturve në familjet biologjike. Ajo dhe drejtuesja e institucionit mbanin kontakte të rregullta me familjarët dhe këto ishin të evidentuara në regjistrin përkatës. Gjithsesi theksojmë se është detyrë e pushtetit vendor për të punuar drejt fuqizimit ekonomik të familjeve që kanë fëmijët në këto institucione. Interesi më i mirë i fëmijës është rritja e tij e kthimi në familjen biologjike, dhe jo transferimi nga institucioni në një tjetër institucion. Pra Bashkitë, e në këtë rast Bashkia Korçë duhet të mundësojë punësimin e prindërve të këtyre fëmijëve për t'i fuqizuar ekonomikisht për mirërritjen e fëmijëve të tyre.

Institucioni nuk kishte edukatore, dhe kjo është shumë e nevojshme pasi 8 fëmijë shkojnë në kopsht (mosha 3-6 vjeç).

Institucioni nuk kishte roje, dhe konsiderohej i domosdoshëm.

Institucioni nuk kishte infermier. Por kjo mangësi mund të rregullohej nëse njëri nga kujdestarët ta kryente edhe këtë funksion.

Nga verifikimi i dosjeve të personelit rezultonte se pjesa më e madhe e punonjësve të këtij institucioni kishin një kohë relativisht të gjatë të punësuar aty, gjë e cila është për t'u vlerësuar. Këta punonjës ishin rekrutuar në zbatim të Kodit të Punës së R.Sh. Trajnimet për stafin kryheshin nga SHSSH, dhe 6 kujdestare do të trajnoheshin për menaxhimin dhe problemet kundër dhunës në Tiranë. Po ashtu nga Drejtuesja e Qendrës ishin miratuar temat e trajnimit për punonjëset për vitin 2016 (hartuar nga mjekja në bashkëpunim me punonjësen sociale).

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë pediatre, e cila aktualisht ishte në pension por që mbulonte shërbimin shëndetësor në këtë institucion me kohë të pjesshme. Ndhimësmjekja në organikën e kësaj shtëpize mungonte.

Të gjithë fëmijët ishin të pajisur me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti. Vaksinimi i fëmijëve në këtë institucion kryhej rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të. Kontrollat periodike mjekësore kryheshin rregullisht, ndërkohë që vizitat tek okulisti si dhe stomatologu duhej të ishin më të shpeshta. Mjekimi i fëmijëve të këtij institucioni si për sëmundjet kronike, ashtu dhe sipas nevojave dhe rasteve që paraqesin probleme shëndetësore nuk kryhej me receta të rimbursueshme, por ilaçet siguroheshin nga institucioni me anë të një fondi buxhetor të posaçëm i cili planifikohej në fillim të çdo viti.

Në këtë institucion mungonte një dhomë e posaçme, e cila do shërbente si infermieri, për vizitat e mjekes, si dhe për mbajtjen e mjekimeve të urgjencës. Gjatë vizitës inspektuese në këtë institucion dollapi që mbante kartelat mjekësore dhe mjekimet e urgjencës gjendej në mensën ku ushqeheshin fëmijë.

Kushtet materiale

Dhomat e gjumit ishin vendosur në katin e dytë të ndërtesës, dhe dyshemetë e tyre ishin me pllaka. Do ishte në të mirë të shëndetit të fëmijëve mundësimi i shtrimit me parket (për moshën 3-6 vjeç).

Në katin e dytë ishin 8 fëmijë të moshës 3-6 vjeç të vendosur në 1 dhomë gjumi. Sipas standardeve ky numër duhet të ishte 4-5 e jo më shumë se 6. Ndaj në këtë pikë duhet parë mundësia e shtimit të ambienteve të gjumit për këta fëmijë.

Kushtet e strehimit dhe furnizimi me artikuj të dhomave të gjumit, të gatimit, etj) ishin në parametra normale.

Problem i konstatuar ishte kutia e ndihmës së shpejtë, e cila ndodhej në kuzhinë dhe mund të aksesohet nga fëmijët.

Pajisjet kundra rrezikut të zjarrit ishin të vendosura në korridore dhe punonjësit ishin të trajnuar nga shërbimi i zjarrfikëseve.

Oborri i institucionit kishte hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, ku fëmijët luanin sipas një plani ditor, të shoqëruar nga edukatorët.

Kutia e ankesave ndodhej në hyrje të Qendrës, me çelës dhe një ekip multidisiplinar e hapte të hënën e parë të çdo muaji. Të drejtat e fëmijëve ishin të afishuara në stenda.

Kampionët ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike.

Edukimi dhe aktivitetet

Ndihmë e vazhdueshme i jepej këtij institucioni nga Fondacioni “Shpresë për Botën” si dhe nga “Terres des Hommes”, sidomos për organizimin e festave të ditëlindjeve, apo aktivitete të tjera argëtuese si dhe dërgimin e fëmijëve mbi 3 vjeç për plazh në Pogradec. Nga grupi inspektues u këqyrën dosje individuale të fëmijëve, të cilat ishin të plotësuara sipas standardeve.

Bazuar në gjetjet e mësipërme, në përfundim të monitorimit, grupi i ekspertëve të Avokatit të Popullit rekomandoi:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për shkurtimin e kohës së nxjerrjes së vendimit nga Komisioni i Vlerësimit të Nevojave (qoftë i Bashkisë, Qarkut apo SHSSH) për transferimin e fëmijës në një tjetër institucion, pasi ka mbushur moshën 6 vjeç. Një vendimmarrje efektive në favor të interesit më të mirë të fëmijës do t'i shërbejë më mirë përkujdesit të plotë për garantimin e çdo të drejtë të tij njerëzore.*
- *Marrjen e masave të menjëhershme për unifikimin e strukturave organike për çdo institucion që financohet nga buxheti i shtetit, duke shmangur në këtë mënyrë kërkesat në dy drejtime (Bashki dhe SHSSH) për të njëjtin problem/objekt si për shtesë punonjësish.*
- *Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me automjet. Konsideruar kufizimet buxhetore, sugjerohet pajisja me një automjet të përbashkët të të tre qendrave të përkujdesit shoqëror publik në Korçë.*
- *Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës me psikolog, edukatore, roje dhe infermier sipas standardeve të miratuara.*

- *Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e standardit që në një dhomë gjumi të mos ketë më shumë se 6 të mitur, pra mundësia e shtimit të ambienteve të gjumit për këta fëmijë.*
- *Marrjen e masave nga ana e Bashkisë Korçë për të mundësuar punësimin e prindërve të këtyre fëmijëve, për t'i fuqizuar ekonomikisht me synimin e mirërritjes së tyre dhe kthimi në familjen biologjike.*

6. Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç VLORE²²

Fillimisht grupi i ekspertëve kreu një takim paraprak me përgjegjësen e sektorit social dhe sociologun (pasi drejtuesja e institucionit ishte me raport mjekësor), të cilat u shprehën të gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit.

Gjatë vizitës inspektuese u këqyrën kushtet materiale në të cilat jetojnë këto fëmijë, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, kuzhina, si dhe dokumentacioni i mbajtur nga stafi i institucionit në lidhje me aktivitetet që zhvillohen për këta fëmijë, kartelat mjekësore, dosjet psiko-sociale dhe edukimin i tyre.

Shtëpia e Fëmijës Vlorë, me një kapacitet zyrtar prej 30 fëmijësh, në momentin e inspektimit kishte 18 fëmijë, (9 djem dhe 9 vajza) nga këta 2 fëmijë me probleme shëndetësore. Një fëmijë kishte dalë nga institucioni me birësim nder vendas. Po ashtu tre fëmijë (vëllezër e motra) ishin sjellë si raste emergjente nga policia, pasi kishin qenë në situatë rruge. Ndaj po punohej nga NJMF e Bashkisë Vlorë për plotësimin e dokumentacionit të tyre. Për një tjetër fëmijë dosja ndodhej në Komitetin Shqiptar të Birësimin, në pritje të birësimin; ndërsa për një fëmijë pritej zbardhja e vendimit të deklarimit të braktisjes nga prindërit. Fëmijët e tjerë ishin të gjithë me interesim nga prindërit.

Varësia nga Bashkia Vlorë dhe SHSSH. Si institucion shtetëror synon kujdesin ndaj fëmijëve të braktisur nga prindërit apo fëmijët të cilët vijnë nga familje me probleme ekonomike dhe sociale. Në nenin 4 të Rregullores së Shtëpisë së Fëmijës Vlorë përcaktohet se ofrohen këto shërbime:

Në nivel specialisti të përfaqësuar nga punonjësi social dhe edukatorja, të cilat mbulojnë edhe nivelin socio-edukativ pedagogjik.

Në nivel shërbimi të përfaqësuar nga kuzhinieret, kujdestaret, sanitaret dhe mirëmbajtësi.

Trajtimi

²² Inspektim i datës 12.04.2016

Fëmijëve iu mundësohej e drejta për takim të rregullt me prindërit e të afërmit. Çdo vizitë lejohej me miratimin e drejtorit. Vizitat nga familjarët bëheshin sipas një programi, për të cilën kujdesej punonjësi social dhe mbahej shënimi në regjistrin përkatës. Kishte një ambient të përcaktuar për këto takime prind-fëmijë dhe gjithmonë në praninë e punonjësit social apo edukatorit. Libri i interesimit të familjarëve për fëmijët, plotësohej nga punonjës të Institucionit, dhe kjo pasi shumë prindër nuk dinin shkrim.

Rregullorja e Qendrës është e miratuar nga Këshilli administrativ i institucionit. Për sistemimin apo lëvizjen e rezidentëve nga institucioni marrin iniciativën prindërit, kujdestarët ligjorë (kur nuk janë prindërit), Institucioni, Komisioni i Vlerësimit në Bashkinë e Vlorës dhe SHSSH. Kur kërkesa bëhet pranë Bashkisë Vlorë dhe kjo e fundit merr vendimin për pranimin (pra sistemimin), më pas miratohet në Këshillin Bashkiak. Pra sistemimi i fëmijëve kryhet me vendim të Këshillit Bashkiak. Po ashtu edhe largimi/ lëvizja e fëmijës nga institucioni kryhej:-kur kthehet në familjen e origjinës; kur birësohet dhe kur kalon në program apo institucione të tjera në varësinë e SHSSH. Vetë 5 fëmijë nuk kishin urdhra pranimi. Dy javë para inspektimit tonë fëmijët (2 motra dhe një vëlla ishin sjellë si raste emergjente-nga rruga, kurse për dy fëmijë të tjerë ishin në proces të marrjes së urdhrit të pranimit.

Të drejtat e fëmijëve nuk i gjetëm të afishuara në muret e godinës.

Problem i konstatuar ishte mungesa e automjetit. Nga drejtuesja e institucionit përdorej makina personale për transport fëmijësh në raste emergjence apo urgjence, si dhe p.sh kur dy fëmijë (mbi 7 vjeç) dërgohen në shkollën “Jani Minga”.

Personeli dhe Organika

Personeli përbëhej nga 20 veta të punësuar nga SHSSH, dhe 8 veta nga Bashkia Vlorë. Pra afro 70% e buxhetit nga SHSSH dhe 30% nga Bashkia e Vlorës. Struktura përfshin dy sektorë: sektorin e Administratës (përgjegjës, 2 kuzhinierë, 1 punëtor mirëmbajtjeje dhe 2 pastrues) dhe Sektorin e Shërbimit Social (përgjegjësi-punonjësi social, 1 edukator dhe 11-kujdestare).

Për më tepër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 infermier

1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Personeli kujdestar dhe edukator ishin kryesisht me arsim të mesëm. Çdo dosje personale e punonjësve që gjende në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Vlorë përmbante diplomat apo dëftesat, kualifikimet e trajnimet, librezën e punës, librezën shëndetësore, kontratën e punës. Nga verifikimi i dosjeve të personelit rezultoi se pjesa më e madhe e punonjësve të këtij institucioni kanë një kohë relativisht të gjatë të punësuar aty. Këta punonjës janë rekrutuar në zbatim të Kodit të Punës së R.Sh, nga Bashkia e Vlorës. Dy punonjës ishin të saporekrutuar: infermieri dhe kujdestari. Dosjet e personelit gjenden në institucion (kopje e tyre); ndërkohë që dosjet origjinale ndodheshin pranë Bashkisë Vlorë. Drejtuesja e kësaj qendre është e diplomuar në Psikologji.

Nga 8 punonjësit e rekrutuar e të paguar me fondet e Bashkisë Vlorë ishin: 1 kushiniere, 1 sanitare, 1 sociologe dhe 5 kujdestare.

Puna ishte e organizuar me tre turne. Çdo turn ka dy kujdestare në katin e 2 dhe dy kujdestare në katin e 3 të godinës.

Institucioni nuk ka psikolog, megjithëse nga punonjësit e kontaktuar na u konfirmua se kërkesat përkatëse i janë drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Po ashtu nuk ka roje.

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e paplotësuar me mjek dhe ndihmës mjek, por nevojat e kësaj qendre mbuloreshin në raste urgjence nga Spitali Pediatrik e Spitali Rajonal i Vlorës, ndërsa detyrën e ndihmësmjekes e kryente një kujdestare e këtij institucioni, e cila ishte e diplomuar për infermieri. Në këto kushte shërbimi shëndetësor në këtë institucion kishte mangësi që në pajisjen e fëmijëve me karta shëndeti, plotësimin e dokumentacionit përkatës të këtij sektori (kartelat mjekësore, regjistrat dhe fletoret vaksinimit, etj.).

Dy nga fëmijët ishin me problem shëndetësor: një me problem psikomotor dhe tjetri me epilepsi fillestare, ishte 7 vjeç dhe na u relatua që një ezhe të kokës ja kishin bërë në spital privat, pasi spitali rajonal nuk e ofronte këtë shërbim.

Gjithashtu kontrollet periodike të fëmijëve të grup moshave të ndryshme, zhvillimi psiko motor, vizitat okulistike, ndërsa shërbimi dentar mungonte në këtë institucion. Në ditën që zhvilluam këtë inspektim i gjithë stafi po organizonte një trajnim lidhur me problem të dhunës ndaj fëmijëve; ndërsa nga Bashkia e Vlorës nuk ishin zhvilluar të tilla trajnime për këtë staf.

Kushtet materiale

Godina ishte tre katëshe: në katin e parë ishin Zyra e drejtueses, financa, zyra sociale, mensa, kuzhina, dhoma e takimit me prindërit, lavanteria, magazina dhe pjesa e detergjenteve. Brenda kuzhinës kishte magazinë ushqimore.

Kati 2-Dhoma e personelit; dhoma e TV, 2 dhoma gjumi për djemtë; 1 dhomë për vajzat (4 veta); klasa e pikturës, vizatimit, dhomë lodrash dhe tualeti.

Kati 3-Dhoma e bebeve, 2 dhoma gjumi (për më të rriturit); klasa ku luajnë të vegjlit; dhoma e prindërve; 2 dhoma lojërash; infermiera dhe tualeti.

-Vetëm 2 dhoma janë me parket, kurse të tjerat janë me pllaka. Ka nevojë për më tepër investime.

-Instalimet elektrike tepër problematike, kabllot jashtë mureve që mund të dëmtojnë jetën e rezidentëve.

-Kuota ushqimore e fëmijëve 0-3 vjeç është 300 lekë; 3-6 vjeç është 310 lekë, e mbi 6 vjeç 330 lekë e cila konsiderohej e mjaftueshme.

Oraret e ngrënies ishin: mëngjesi 7.30-8.00; vakti i vogël 10.00-10.30; dreka 12.00-12.30; vakti i pasdites 16.00-16.30; darka 19.00-19.30. Përgatitej menuja javore, nga një grup punonjësesh të qendrës dhe afishohej. Dy menu, për fëmijët 0-2 vjeç dhe 3-6 vjeç. -Kampionët ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike.

-Kushtet e strehimit dhe furnizimi me artikuj të dhomave të gjumit, të gatimit, etj ishin në parametra normale. Artikulli “veshje” ose ai me numër 602 mbulohej nga Bashkia e Vlorës.

-Ngrohja dhe ftohja e ambienteve kryhej me kondicionerë.

-Nevoja e vendosjes së tendave për diellin në dritaret e katit të 2 dhe të 3 për stinën e nxehtë të verës.

-Pajisjet me bombola kundra rrezikut të zjarrit ishin të vendosura në çdo kat, por punonjësit nuk ishin të trajnuar nga shërbimi i zjarrfikëseve dhe për rastet e emergjencave.

-Kutia e ankesave ndodhej në hyrje të Qendrës, me çelës dhe një ekip multidisiplinar me punonjës të DR të SHSSH Vlorë, e hapte një herë në muaj.

-Mungesa e një automjeti kufizon edhe lëvizjet për argëtimin e fëmijëve. Po ashtu edhe oborri i jashtëm ka nevojë për investime me qëllim argëtimin me lojëra të fëmijëve.

Edukimi dhe aktivitetet

Drejtuesja në bashkëpunim me specialistët hartonte planet edukative të zhvillimit si dhe planet e punës së çdo sektori. Punonjësi social dhe drejtuesi mbante kontakte të rregullta me familjarët dhe këto ishin të evidentuara në regjistrin përkatës. Dita e takimit të fëmijëve me prindërit ishte caktuar e mërkura, por kishte fleksibilitet në këtë proces.

Gjithsesi theksojmë se është detyrë e pushtetit vendor për të punuar drejt fuqizimit ekonomik të familjeve që kanë fëmijët në këto institucione. Interesi më i mirë i fëmijës është rritja e tij e kthimi në familjen biologjike, dhe jo transferimi nga institucioni në një tjetër institucion. Pra Bashkitë, e në këtë rast Bashkia Vlorë duhet të mundësojë

punësimin e prindërve të këtyre fëmijëve për t'i fuqizuar ekonomikisht për mirërritjen e fëmijëve të tyre.

Në mënyrë që Shtëpia e Fëmijës Vlorë si institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët, të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale,

REKOMANDOJMË

1-Marrjen e masave për vendosjen e një automjeti për transportin e fëmijëve.

2-Marrjen e masave për plotësimin e mungesave në burimet njerëzore të stafit si psikologu, mjeku e roja.

3-Marrjen e masave për ndërtimin e shkallëve të daljes për raste emergjencash duke përmbytur standardet e rregullores kundër rreziqeve nga zjarri.

4-Marrjen e masave për trajnimin e stafit për probleme të zhvillimit e përkujdesit ndaj fëmijëve si dhe për rastet e emergjencave nga zjarri.

5-Marrjen e masave për shmangia e plotësimit formal të librit të interesimit të familjarëve për fëmijët nga punonjës të Institucionit.

6- Marrjen e masave të menjëhershme për kryerjen e instalimeve të reja elektrike, sepse rrjeti elektrik rezultonte tejet i amortizuar dhe në dëm të shëndetit të fëmijëve.

7. Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç “Hana dhe Rozafa”, TIRANE

Shtëpia e Foshnjës Tiranë, me një kapacitet zyrtar prej 50 fëmijësh, në momentin e inspektimit kishte 24 fëmijë, (0-6 vjeç) një pjesë e të cilëve ishin të braktisur që në maternitet, kurse pjesa tjetër jetimë të vendosur në institucion me urdhër pranimi emergjent. 13 fëmijë ishin 0-1 vjeç dhe 11 fëmijë ishin 1-6 vjeç. Të ndarë me grup moshë ishin:

3 fëmijë ishin 6-8 muajsh;

5 fëmijë ishin nën 12 muajsh

5 fëmijë ishin 13-18 muajsh

4 fëmijë ishin 18-24 muajsh

2 fëmijë ishin 2-3 vjeç

4 fëmijë ishin 3-4 vjeç

1 fëmijë ishte 6 vjeç

Varësia nga Shërbimi Social Shtetëror.

Trajtimi

Përsa i përket të drejtës së takimit me prindërit, fëmijëve iu mundësohej takimi i rregullt me prindërit e të afërmit. Vizitat nga familjarët bëheshin sipas një programi, për të cilën kujdesej punonjësi social dhe mbahej shënimi në regjistrin përkatës. Kishte një ambient të përcaktuar për këto takime prind-fëmijë dhe gjithmonë në praninë e punonjësit social apo edukatorit.

Institucioni ka si bazë rregullimi të brendshëm Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucioneve rezidenciale të përkujdesit social për fëmijët 0-6 vjeç, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH me datë 31.12.2015.

Të drejtat e fëmijëve ishin të afishuara në muret e godinës.

Problem i konstatuar ishte mungesa e kamerave ashtu si dhe në institucionet e tjera publike të përkujdesit rezidencial për fëmijët.

Për 6 fëmijë të këtij Institucioni dosjet ndodheshin në Komitetin Shqiptar të Birësimeve, pra në pritje të birësimit.

-Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të pjesshme, dhe paga e saj si dhe e disa prej punonjësve të këtij institucioni mbulohej nga shërbimet sociale "Bethany", ndërsa ndihmës mjekja mungonte në organikë. Gjithashtu shërbimi dentar mbulohej me një stomatolog privat nga OJF "Bethany".

- Me karta shëndeti ishin të pajisur vetëm 9 fëmijë pjesa tjetër ishte në proces të plotësimit të dokumentacionit përkatës për pajisjen e këtyre të fundit me to.

-Ekzistonin regjistrat e vaksinimit të fëmijëve dhe regjistri i medikamenteve të cilët plotësoheshin me rregull nga mjekja.

-Ka mjek part-time, por shumë i nevojshëm konsiderohej punësimi i mjekut me kohë të plotë. Mjekja e institucionit bënte një mbulim të mirë të të gjithë vizitave dhe kontroleve periodike të fëmijëve në këtë shtëpi, por duke qenë se ajo mbulonte vetëm këtë shtëpi dhe nuk kishte një kod mjeku familjeje, recetat me ilaçe të përshkruara prej saj nuk aplikoheshin me rimbursim, por blerja e tyre sigurohej nga një fond buxhetor i posaçëm i institucionit, i cili parashikohej që në fillim të vitit.

-Nga këqyrja e kartelave mjekësore dhe regjistrave të këtij sektori rezultoi se vaksinimi i fëmijëve bëhej rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të.

Aktualisht institucioni kishte dy fëmijë me probleme shëndetësore: një fëmijë me sindromën doën e për të cilin Qendra Jonathan, ndihmon mjaft për kryerjen e fizioterapisë së tij, dhe një fëmijë tjetër-8 mujash me diagnozën "tostoplazmozë" e për të cilin problematike ishte kryerja e një ndërhyrjeje mjekësore-tepër e kushtueshme, pasi duhej marrë miratimi i të ëmës.

Personeli dhe Organika

Personeli përbëhet nga 38 punonjës të ndarë në dy sektorë: sektorin e Administratës-9 punonjës (përgjegjësi i sektorit, magazinieri, 2 kuzhinierë, 1 shofer; 1 punonjës mirëmbajtjeje dhe 3 pastruese) dhe Sektorin Social- 29 punonjës (përgjegjësja-psikologe, 1 edukator, 1 krye kujdestare dhe 23 kujdestare dhe 3 punonjës socialë).

Për më tepër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimin të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 infermier

1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Nuk ka psikolog. Kërkesa përkatëse për shtimin e një psikologu dhe të një mjeku ishte paraqitur në SHSSH para dy vitesh.

Nuk ka infermier, megjithëse disa kujdestare janë me profesion “infermiere”, por nuk e kanë të tillë përshkrimin e pozicionit të punës apo të jenë të licencuara të ushtrojnë këtë zana dhe kjo dilte e domosdoshme në rastet e emergjencave kur për fëmijët duhej mjekim.

Institucioni ka punësuar rojën e institucionit. Disa punonjës paguheshin nga Fondacioni Bethany.

Vijimësia e punës së stafit, jo vetëm krijon siguri në punën me fëmijët, por eksperiencia e tyre përbën një aset për pjesën e re të punonjësve. Gjithsesi trajnimet e vazhdueshme për aspekte të ndryshme të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve janë të nevojshme jo vetëm për punonjësit e rinj, por edhe pjesën “më me eksperiencë pune” të këtyre institucioneve rezidenciale.

Dosjet me dokumentet origjinale të rekrutimit të stafit, ndodhen në SHSSH. Kopje të dosjeve të punës për çdo punonjës si dhe kopje të kontratave të punës-të cilat ishin pa afat janë të mbajtura rregullisht në Institucion. Ndërkohë që shpallja e vendeve vakante si dhe dosjet origjinale të punonjësve kryhen dhe mbahen nga Shërbimi Social Shtetëror. Gjithsesi nga inspektimi na rezultoi për disa punonjës nuk ishin kopjet e kontratave të punës në dosjet personale.

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të pjesshme, dhe paga e saj si dhe e disa prej punonjësve të këtij institucioni mbulohej nga shërbimet sociale “Bethany”, ndërsa ndihmës mjekja mungonte në organikë.

Kushtet materiale

Kuota ushqimore e fëmijëve 0-3 vjeç është 300 lekë; 3-6 vjeç është 310 lekë, e cila konsiderohej e mjaftueshme, ashtu si dhe për institucionet e tjera rezidenciale publike për fëmijët. Kampionët ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike.

Organizimi i punës ishte me tre turne në oraret 6.30-14.30; 14.30-22.30; 22.30-6.30 Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes së ambienteve të dy godinave realizohej me panel diellor dhe kaldajë.

Furnizimet me artikuj hotelerie ishte mjaft i mirë, i bollshëm dhe si pasojë e mirë menaxhimit si dhe e donacioneve të shumta, kushtet paraqiteshin shumë optimale për kujdesin e mirërritjen e këtyre fëmijëve.

Për shkak të pozicionit tepër të favorshëm, në Sauk-Tiranë, ku gjendet ky institucion, konsiderohet si mjaft tërheqës edhe pjesa e organizimit jashtë godinave, me lodrat dhe gjelbërimin.

Edukimi dhe aktivitetet

Dy nga fëmijët e këtij Institucioni dërgoheshin për tu socializuar/ integruar dhe ambientuar me fëmijë jashtë institucionit tek një kopësht privat "Topolino" që gjendej afër tij, dhe po punohej që vitin e ardhshëm shkollor të mund të dërgojnë atje edhe tre fëmijë të tjerë. Po ashtu një herë në javë fëmijët dërgoheshin në Teatrin e Kukullave.

Çdo ditë fëmijët marrin pjesë në programin mësimor të moshës, i përgatitur në fillim të çdo muaji dhe i detajuar. E po ashtu zhvilloheshin terapitë e lojës dhe muzikës

Mungesa e një automjeti kufizon edhe lëvizjet për argëtimin e fëmijëve. Po ashtu edhe oborri i jashtëm ka nevojë për investime me qëllim argëtimin me lojëra të fëmijëve.

Në mënyrë që Shtëpia e Foshnjës Hana dhe Rozafa, Tiranë si institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët 0-6 vjeç të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale,

REKOMANDOJMË

1-Marrjen e masave për plotësimin e mungesave në burimet njerëzore të stafit si psikologu, mjekut me kohë të plotë e infermieres në përputhje me standardet²³.

2- Marrjen e masave për plotësimin e disa dosjeve të personelit me dokumentet e munguara.

²³ VKM nr. 659, datë 17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale".

3- Marrjen e masave për kryerjen e termoizolimit të Godinës Rozafa.

8. Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë²⁴

Shtëpia e Fëmijës Tiranë, me një kapacitet zyrtar prej 48 fëmijësh, në momentin e inspektimit kishte 45 fëmijë (6-18 vjeç), nga këta 24 ishin vajza dhe 21 djem.

Institucioni ka varësinë nga Shërbimi Social Shtetëror.

Institucioni kishte deklaratën e Qëllimit sipas standardeve, dhe kopja e saj ishte e afishuar në institucion. Po ashtu institucioni ka rregulloren e tij të brendshme; udhëzuesin e sjelljes për stafin.

Objektivi i viti 2016 për këtë institucion ishte de institucionalizimi²⁵, ndaj ka filluar zbatimin e planit për transformimin e shërbimeve rezidenciale në formë të kujdesit të tipit shtëpi - familje dhe komunitare.

Organizimi i saj ishte mbi bazën e 4 apartamenteve (casa-famiglia) sipas grup moshave 6-10 vjeç; 11-14 vjeç; 14-16 vjeç dhe 16-18 vjeç.

Por pavarësisht synimit të afrimit sa më afër tipit (modelit) të shtëpisë domosdoshmëri paraqiste rregullimi i infrastrukturës (ambienteve fizike të ndërtesës sipas këtyre grup moshave).

Në apartamentin 1 kishte 11 fëmijë të grup moshave 6-9 vjeç. Punonte një staf prej 4 vetash me tre turne. Të ndara ambientet me 4 dhoma gjumi dy për djem dhe dy për vajzat. Në këtë apartament ishte e vetmja tharëse rrobash për gjithë institucionin.

Në apartamentin 2 ishin vendosur 12 fëmijë të moshës 9-12 vjeç.

Në apartamentin 3 ishin vendosur 10 fëmijë të moshës 11-14 vjeç. Kishte një kabinet informatike; por kishte lagështirë në muret e korridoreve dhe nuk kishte ujë të ngrohtë.

Në apartamentin 4 ishin vendosur 9 fëmijë të moshës 14-16 vjeç. Ambienti ishte me mjaft shenja lagështire në mure.

Trajtimi

Përsa i përket të drejtës së takimit me prindërit, fëmijëve iu mundësohej takimi i rregullt me prindërit e të afërmit. Vizitat nga familjarët dokumentoheshin dhe mbaheshin shënimet në regjistrin përkatës. Kishte një ambient të përcaktuar për këto takime prind-fëmijë. Institucioni ka si bazë rregullimi të brendshëm. Kishte mjaft fleksibilitet në oraret e takimit të prindërve me fëmijët, të cilët megjithëse i kanë përcaktuar bashkërisht oraret, ndodh që mund të paraqiteshin edhe në orë e ditë të ndryshme. Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të

²⁴ Janë kryer tre vizita në këtë institucion: 11.02.2016; 25.04.2016 dhe 13.06.2016

²⁵ Urdhri i Ministrisë së Mirëqënies Sociale nr 55 datë 02.03.2015 “Për Miratimin e Planit të Veprimit të Deinstitutionalizimit për Shtëpinë e Fëmijës Zyber Hallulli”

institucioneve rezidenciale të përkujdesit social për fëmijët 6-18 vjeç, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH me datë .31.12.2015.

Rregullorja e Qendrës duhet të ketë më mirë të përcaktuar punën e fundjavës me fëmijët.

Të drejtat e fëmijëve ishin të afishuara në muret e godinës.

Për disa fëmijë që prindërit (nënë) e kishin në burg bashkëpunohet për realizimin e takimeve të paktën një herë në muaj me IEVP “Ali Demi” Tiranë.

Për vitin 2015 ishin realizuar 3 birësime fëmijësh.

Nuk ka infermier. Ilaçet për fëmijët kur sëmuren i jep kujdestari i turnit (mbi bazën e shënimit të mjekut). Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të plotë, por mungonte ndihmës mjekja.

Ndaj duhet të studiohet problem i rregullimit dhe i ri sistemit të fëmijëve pasi grup moshë e përfituesve është mjaft e gjerë, nga 6 deri në 18 vjeç. Në këtë kuptim duhet rregulluar më mirë edhe kuota ditore ushqimore (pasi nevojat e një 6 vjeçari ndryshojnë nga ato të një 18 vjeçari).

Problematikë që na u relatua dhe që kërkon mbështetje për zgjidhje ishte ai i kartës së shëndetit për një fëmijë 16 vjeç, që nuk vijonte shkollën.

Po ashtu drejtuesit e punonjësit e institucionit ndeshnin vështirësi në kontaktimin e marrjen e informacioneve për disa prindër fëmijësh. Në këtë kuadër informuam se mund ta “përdornin” institucionin e Avokatit të Popullit si lehtësues e ndihmës në realizimin e zgjidhjen e çdo zvarritjeje apo parregullsie që mund të ndeshnin nga kontaktet e korrespondencat me organet e administratës publike kryesisht vendore. Shërbimi dentar ofrohet nga stomatologu i shkollës “Osman Myderizi” që frekuentonin fëmijët e kësaj shtëpie, por ndërhyrjet e vetme që kryente ai ishin ekstraksione dhe mjekime lokale.

Në këtë institucion ndodheshin 3 fëmijë të diagnostikuar nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor nr. 1, Tiranë me probleme të shëndetit mendor.

Vaksinimi i fëmijëve në këtë institucion bëhet rregullisht dhe sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të.

Kartelat mjekësore si dhe ndjekja e kontrolleve periodike mjekësore të fëmijëve, nuk ishin të unifikuara.

Pajisja me karta shëndeti e të gjithë fëmijëve të kësaj shtëpie ishte në proces për shkak të plotësimit të të gjithë dokumentacionit përkatës të nevojshëm për këtë procedurë.

Për 8 të rinj ka filluar aftësimi i tyre për punësim.

Një rast për të cilin gjykata kishte vendosur marrjen e një psikologu tjetër (proces i vendosjes së fëmijës në kujdestari) dhe Institucioni nuk kishte mundësinë e pagimit të këtij shërbimi, përderisa ka psikologun e tij në organikë.

Kutia e ankesave çelej një herë në muaj, me një komision ku përfshihej punonjësi social si dhe përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e SHSSH Tiranë.

Personeli dhe Organika

Organika përbëhet gjithsej nga 36 punonjës. Përkatësisht ishin drejtori, përgjegjësi i sektorit social me 23 veta si sektor; sektori i administratës me 12 veta staf. Sektori social mbulohej nga dy punonjëse sociale, nga të cilat njëra ishte përgjegjësi e këtij sektori dhe dy psikologe. Janë shtuar një mjek dhe një infermier, të dy me kohë të pjesshme, bazuar në VKM nr. 231 datë .20.01.2016 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”.

Për sa më sipër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 mësues i arsimit profesional

1-20 fëmijë- 1 infermier

1-20 fëmijë- 1 mjek i përgjithshëm.

Kërkesat e standardeve për mësues të arsimit profesional, të një mjeku dhe infermieri të punësuar me kohë të plotë nuk përmbushen.

Nga trajnimi i zhvilluar për stafet e të gjitha institucioneve rezidenciale publike nga ana e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, vetëm 3 punonjës nuk arritën ta merrnin provimin, dhe janë ri trajnuar për këtë qëllim. Rezultatet e vlerësimit të njohurive dhe aftësive të personelit në institucionet e përkujdesit social publik për vitin 2015 ishin dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Sociale-Drejtoria e Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara e MMRS. E po ashtu trajnimet për të gjithë stafin kryheshin si nga SHSSH, por duke bashkëpunuar dhe marrë edhe pëlqimin e drejtuesve të qendrës.

Problem i konstatuar ishte që dosjet origjinale të punonjësve mbaheshin në SHSSH, dhe institucioni mban dosjet e fotokopjuara.

Shoferi është edhe mirëmbajtës në organikë, por me donacion kanë siguruar automjetin.

Kushtet materiale

Institucioni në kuadrin e deinstitutionalizimit dhe për shërbimet sa më miqësore e më pranë modelit të familjes ishte i ndarë brenda të njëjtës ndërtesë në 4 shtëpi-familje.

Përveç kushteve dhe furnizimit optimal me pajisje hotelerie e veshje për fëmijët, edhe me donacione, e konsiderojmë të domosdoshme përmirësimin e infrastrukturës së godinës për t'i përshtatur e ndarë më mirë fizikisht shtëpitë-familje brenda institucionit

Kampionët ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike.

Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes së ambienteve të dy godinave realizohej me panel diellor dhe kaldajë.

Furnizimet me artikuj hotelerie ishte mjaft i mirë, i bollshëm dhe si pasojë e mirë menaxhimit si dhe e donacioneve të shumta, kushtet paraqiteshin shumë optimale për kujdesin e mirërritjen e këtyre fëmijëve. Problem i konstatuar është kuota ditore ushqimore, e cila besojmë që duhet të jetë e ndryshme nga fëmija 6 vjeç tek të rinjtë 16-18 vjeç.

Edukimi dhe aktivitetet

36 fëmijë frekuentonin shkollën 9 vjeçare “Osman Myderizi”, 1 fëmijë ndiqte një shkollë private (nisur dhe nga ecuria e mirë në shkollë) dhe tre fëmijë të tjerë janë të regjistruar dhe ndjekin mësimin në shkollën e mesme teknologjike në Tiranë.

Mjaft aktivitete zhvilloheshin në kohën e lirë të fëmijëve dhe kjo si me mbështetjen nga fondet e buxhetit të shtetit ashtu dhe me mbështetje donatorësh. Zhvilloheshin kurse futbollit, noti, me grupe të integruar dhe me fëmijë jashtë institucionit.

Vlen të përmendim bashkëpunimin mjaft të mirë me organizatën ATLAS në përgatitjen e dokumentacionit të fëmijëve, sipas akteve nënligjore.

Institucioni zhvillonte me plan të detajuar mjaft aktivitete social-kulturore për fëmijët rezidentë. Kjo jo vetëm me mbështetjen buxhetore nga shteti, por edhe me donator privatë. Konkretisht zhvilloheshin kurse futbollit, noti, dhe me grupe të integruara prej 5-6 fëmijësh jashtë institucionit.

Në vijim të inspektimit, vizita tjetër në këtë institucion ishte me datën 13.06.2016, nga grupi multidisiplinar. Objekti i inspektimit ishin verifikimi i trajtimit të fëmijëve në këtë institucion. Ky objekt, në mungesë të drejtoreshës gjatë takimit paraprak, iu bë me dije përgjegjëses së sektorit social, e cila konfirmoi se në ditën e inspektimit në këtë institucion ishin rezidentë 29 fëmijë të moshës 6-18 vjeç, ndërkohë që 13 fëmijë ishin pranë familjeve me leje që varionin nga disa ditë deri në disa javë. Për këtë arsye, jeta në shtëpitë-familje brenda institucionit ishte riorganizuar dhe fëmijët ishin rishpërndarë. Duke qenë se nuk kishin ndodhur ndryshime të qenësishme në institucion nga vizita e fundit, grupi inspektues u fokusua kryesisht në intervista konfidenciale, më vete e në grupe të vogla, me të gjithë fëmijët e pranishëm në institucion, lidhur me trajtimin e tyre nga ana e stafit të këtij institucioni.

Nga bisedat e kryera me fëmijët e grup-moshave të ndryshme, nuk u konstatuan raste të përdorimit të dhunës psikologjike apo fizike. Nga këto biseda, rezultoi se si masa ndëshkuese ndaj fëmijëve që bënin thyerje disipline përdorëshin teknikat “*time out*” (dërgimi i fëmijës në dhomën e fjetjes, ose ndërprerja e aktivitetit për fëmijën

dhe dërgimi i tij/saj në një dhomë tjetër për reflektim për një kohë që nuk i kalonte 30 minutat), si dhe ndalimi i fëmijëve për të marrë pjesë në aktivitete specifike rekreative. Fëmijët po ashtu pohonin se edhe këto masa në një pjesë të madhe të rasteve nuk aplikoheshin, pasi ata kërkonin ndjesë, premtonin mos përsëritje dhe gjenin mirëkuptimin e kujdestarëve ose të stafit.

Po nga intervistimi i fëmijëve, u konstatua se fëmijët më të rritur të moshës 12 vjeç e lart ishin përgjegjës-përmes një grafiku javor të njohur prej tyre- në procesin e rregullimit të tavolinave pas vakteve, larjes dhe sistemimit të enëve, si dhe të pastrimit të dyshemesë së ambientit të ngrënies. Në këtë proces ata ishin të ndihmuar nga fëmijë të moshës 9-vjeç e lart. Fëmijëve iu kërkua të tregonin ku ishin të vendosura grafikët. Për habinë e tyre këta grafikë nuk qëndronin më të varur në ambientet ku gjendeshin më parë, por siç u shprehën, për ta kjo nuk përbënte problem pasi secili e dinte ditën kur ky proces ishte në përgjegjësinë e tij. Fëmijët u pyetën nëse në këtë proces ishte i përfshirë stafi përkatës i turnit, por ata pohuan që kjo gjë nuk ndodhte. Për rastet kur fëmijët e turnit ishin të pamundur, ata zëvendësoheshin me mirëkuptim mes njeri-tjetrit nga fëmijë të një dite tjetër grafiku. Fëmijët u pyetën nëse merrnin pjesë dhe në aktivitete të tjera të mirëmbajtjes së ambienteve të përbashkëta (p.sh. tualeteve, kopshtit, etj), por përveç mirëmbajtjes së dhomave, kjo gjë nuk u verifikua të ndodhte. Fëmijët u pyetën nëse merrnin pjesë në aktivitete të tjera të higjienës të tilla si procesi i larjes dhe hekurosjes së rrobave të tyre, por ata pohuan se kjo kryhej nga stafi. Ata ishin të përfshirë vetëm në ndarjen dhe marrjen e rrobave personale.

Sa më sipër u konfirmua edhe nga bisedat me stafin e kujdesit social dhe drejtoreshën e institucionit.

Nga shqyrtimi i dosjeve të fëmijëve dhe veçanërisht i planeve individuale të kujdesit dhe raporteve për vlerësim të nevojave dhe ecurisë, nuk u konstatua të ishin specifikuar detaje mbi mënyrën e përfshirjes së fëmijës/ fëmijëve në aktivitete të ashtuquajtura “të aftësimin për jetën”, të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e fëmijëve për të jetuar në mënyrë të pavarur pas de institucionalizimit.

Në këto kushte, përfshirja e planifikuar e fëmijëve në aktivitete të mirëmbajtjes së higjienës kolektive, qoftë kjo edhe për qëllime edukative, pa marrë në konsideratë moshën minimale të tyre, pa e rregulluar/ specifikuar në akte të brendshme, pa përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje, pa e parashikuar në planet individuale të kujdesit, dhe pa specifikuar se ky aktivitet nuk ndikon në kohën e nevojshme që i duhet fëmijëve për të kryer aktivitete të tjera primare për zhvillimin e tyre, rrezikon të bjerë ndesh me standardet ndërkombëtare të drejtave të fëmijëve mbi mbrojtjen nga shfrytëzimi për punë të detyruar. Mungesa e këtyre rregullimeve, përkrah mungesës së qëndrueshmërisë në përdorimin e masave ndëshkimore edukative dhe përforcimit negativ, rrezikon të prodhojë efekt të kundërt me atë që duhet të jetë edukimi i vazhdueshëm për aftësimin për jetesë të pavarur.

Neni 32 i Konventës së OKB “Për Mbrojtjen e Fëmijëve”, parashikon se: “Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t’u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cenon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.”.

Në legjislacionin vendas, duke filluar nga Kushtetuta e R.SH në pikën 3 të nenit 54, parashikohet se: *Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.*

Po ashtu, në Ligjin Nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, në nenin 22 *Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik, pika 1*, parashikohet se:

1. *Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune që:*

a) *paraqet rreziqe;*

b) *cënon edukimin;*

c) *dëmton shëndetin;*

ç) *dëmton zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror;*

d) është e detyruar.

Duke qenë se në legjislacionin shqiptar ndalohet puna e detyruar e fëmijëve, me qëllim diferencimin midis asaj që kuptohet me termin “*punë e fëmijëve*” dhe se çfarë është e pranueshme dhe e papranueshme, në Konventat dhe Rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në lidhje me punën e fëmijëve, specifikohet se çfarë nuk përfshihet në termin “puna e fëmijëve”. Sipas ILO “Pjesëmarrja e fëmijëve dhe e adoleshentëve në punë e cila nuk ndikon në shëndetin dhe zhvillimin e tyre vetjak ose nuk pengon arsimimin e tyre, vlerësohet në përgjithësi si diçka pozitive. Kjo ka të bëjë me aktivitete që lidhen me ndihmën ndaj prindërve në shtëpi dhe në familje, me ndihmën në biznesin familjar apo me fitimin e parave të xhepit jashtë orëve të mësimin dhe gjatë pushimeve të verës. Kjo gjithë kontribuon në zhvillimin e fëmijëve dhe në mirëqenien e familjeve të tyre; i pajis ata me shprehje, aftësi dhe përvojë dhe i ndihmon të përgatiten për të qenë anëtarë produktivë dhe të përshtatshëm të shoqërisë gjatë jetës së tyre si të rritur”. Po në të njëjtat konventa e rekomandime “Puna e fëmijëve” i referohet punës e cila:

- mendërisht, fizikisht, shoqërisht është e dëmshme dhe e rrezikshme për fëmijët; dhe

-ndërhyn në shkollimin e tyre:

- duke i privuar ata nga mundësia për të ndjekur shkollën;

-duke i detyruar ata të lënë shkollën para kohe; ose

-duke i kërkuar atyre të përpiqen të kombinojnë pjesëmarrjen në shkollë me punë mjaft të rëndë dhe me orë të zgjatura”.

Konsideruar sa më sipër, në mënyrë që praktikatat e edukimit përmes përfshirjes të mos bien ndesh me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare të

drejtave të fëmijëve mbi mbrojtjen nga shfrytëzimi për punë të detyruar, ndaj duhet marrje masash të menjëhershme me qëllim rregullimin sa më të qartë e të saktë të çështjes së përfshirjes së fëmijëve në aktivitete të mirëmbajtjes së higjienës personale e kolektive. Kjo kërkon që në hartimin e planeve individuale të kujdesit, të merret në konsideratë nevoja specifike e çdo fëmije në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të tij/të saj për edukim me fokus aftësitë për jetën e pavarur pas deinstitutionalizimit. Në këtë proces vendimmarrje është mjaft e rëndësishme përfshirja e fëmijës, vlerësimi mbi ndikimin e mundshëm që ky aktivitet do të ketë në kohën e nevojshme që i duhet fëmijëve për të kryer aktivitete të tjera primare zhvillimore, si dhe sistemi i shpërblimit që do të përdoret për përfshirjen e vlerësuar. Në çdo rast kjo përfshirje nuk duhet të zëvendësojë punën e stafit, por duhet të udhëhiqet e të modelohet nga ana e këtyre të fundit.

Në mënyrë që Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë si institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët 6-18 vjeç të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në Institucionet Rezidenciale,

REKOMANDOJMË

1-Marrjen e masave që në kuadrin e ofrimit të shërbimeve miqësore e sa më pranë modelit të familjes, përmirësimin infrastrukturor të godinës, për një ndarje sa më të arsyeshme të shtëpive-familje nga njëra-tjetra.

2-Plotësimin e mungesave në burimet njerëzore të stafit.

3-Plotësimi sa më shpejt me karta shëndeti të të gjithë fëmijëve rezidentë.

4- Marrjen e masave të menjëhershme me qëllim rregullimin sa më të qartë e të saktë të çështjes së përfshirjes së fëmijëve në aktivitete të mirëmbajtjes së higjienës personale e kolektive. Kjo kërkon që në hartimin e planeve individuale të kujdesit, të merret në konsideratë nevoja specifike e çdo fëmije në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të tij/ saj për edukim me fokus aftësitë për jetën e pavarur pas deinstitutionalizimit. Në këtë proces vendimmarrje është mjaft e rëndësishme përfshirja e fëmijës, vlerësimi mbi ndikimin e mundshëm që ky aktivitet do të ketë në kohën e nevojshme që i duhet fëmijëve për të kryer aktivitete të tjera primare zhvillimore, si dhe sistemi i shpërblimit që do të përdoret për përfshirjen e vlerësuar. Në çdo rast kjo përfshirje nuk duhet të zëvendësojë punën e stafit, por duhet të udhëhiqet e të modelohet nga ana e këtyre të fundit.

9. Shtëpia e Fëmijës Shkollor 6-18 vjeç, Sarandë²⁶.

²⁶ Inspektim i datës 13.04.2016

Gjatë vizitës inspektuese u këqyren kushtet materiale në të cilat jetojnë këto fëmijë, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, kuzhina, si dhe dokumentacioni i mbajtur nga stafi i institucionit në lidhje me aktivitetet që zhvillohen për këta fëmijë, kartelat mjekësore, dosjet psiko-sociale, shkollimi dhe edukimi i tyre. Gjithashtu, nëpërmjet bisedave dhe intervistave konfidenciale me fëmijët e grup-moshave të ndryshme, grupi inspektues u ndal veçanërisht në mbledhjen e të dhënave lidhur me trajtimin e tyre nga ana e stafit të këtij institucioni.

Në takimin e bërë me drejtuesit e këtij institucioni, u informuam se aty trajtoheshin fëmijë, nga mosha 6-18 vjeç. Aktualisht nga 33 fëmijë rezidencialë (15 vajza dhe 18 djem) që kishte gjithsej, 7 prej tyre ishin jetimë biologjik, ndërsa pjesa tjetër ishin nga familje me probleme sociale. Grup moshat e këtyre fëmijëve janë : 2 fëmijë të moshës 17 vjeç; 2 fëmijë të moshës 16 vjeç; 2 fëmijë të moshës 15 vjeç; 4 fëmijë të moshës 14 vjeç; 4 fëmijë të moshës 13 vjeç; 6 fëmijë të moshës 12 vjeç; 3 fëmijë të moshës 11 vjeç; 2 fëmijë të moshës 10 vjeç; 4 fëmijë të moshës 9 vjeç; 3 fëmijë të moshës 8 vjeç dhe 1 fëmijë i moshës 7 vjeç.

Ndërkohë si Qendër Ditore trajtonte 11 fëmijë, pra me frekuentim ditor kryesisht nga familje me probleme ekonomike e për të cilët vendoset nga pushteti vendor frekuentimi i këtij Institucioni.

Ky Institucion ka varësi nga Bashkia e Sarandës dhe financohet nga buxheti i shtetit, drejtuesja e qendrës na konfirmoi se ka patur edhe donacione (sidomos nga fondacioni “Shpresë për Botën) apo dhe donatorë të tjerë.

Trajtimi

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të pjesshme dhe një ndihmësmjeko. Mjekja e këtij institucioni mbulonte si mjekë familjeje Qendrën Shëndetësore Nr. 2 të Sarandës.

Me karta shëndeti ishin të pajisur 30 fëmijë të shtëpisë dhe vetëm tre ishin në proces të plotësimit të të gjithë dokumentacionit përkatës. Ndërkohë që për fëmijët që kishin nevojë për trajtim medikamentoz nuk aplikoheshin receta me rimbursim, por ilaçet siguroheshin me një fond buxhetor të posaçëm të institucionit të planifikuar në çdo fillim viti.

Vaksinimi i fëmijëve në këtë shtëpi kryhej sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të.

Shërbimi stomatologjik në këtë institucion ofrohej nga shërbimi dentar i poliklinikës Sarandë, i cili mbulonte në mënyrë të pjesshme të gjitha ndërhyrjet e nevojshme për fëmijët (Mjekime lokale, ekstraksione), ndërsa terapitë që kishin nevojë për ndërhyrje më të plota dhe me materiale dentare kryheshin nga stomatolog privatë me donacione.

Kontrollet periodike mjekësore kryheshin rregullisht për të gjithë fëmijët, ndërsa ishte e domosdoshme kryerja me rigorozitet e vizitave periodike tek okulisti dhe stomatologu.

Problemi i akomodimit të fëmijëve jetimë kur dalin nga Shtëpia e fëmijës, duhet studiuar dhe mirë rregulluar nga shteti dhe jo të lihet vetëm në dorë të organizatave të ndryshme. Problemi më i madh është sidomos për ata fëmijë që transferohen pranë familjes biologjike ose në një jetesë të pavarur.

Kuota ditore ushqimore ishte 330 lekë për fëmijët rezidencialë dhe 220 lekë për fëmijët me frekuentim ditor. Si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimeve, kjo kuotë e vendosur që në vitin 2012 duhet rishikuar dhe konsiderohej e nevojshme rishikimi i saj edhe si pasojë e rritjes së moshës së qëndrimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror nga 16 vjeç në 18 vjeç. Por edhe pse është parë e arsyeshme të rriten këto kuota, nuk është bërë asgjë, pasi këto ndryshime bëhen vetëm me vendim qeverie. Kuota ditore ushqimore ishte 330 lekë për fëmijët rezidencialë dhe 220 lekë për fëmijët me frekuentim ditor. Si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimeve, kjo kuotë e vendosur që në vitin 2012 duhet rishikuar dhe konsiderohej e nevojshme rishikimi i saj edhe si pasojë e rritjes së moshës së qëndrimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror nga 16 vjeç në 18 vjeç. Por edhe pse është parë e arsyeshme të rriten këto kuota, nuk është bërë asgjë, pasi këto ndryshime bëhen vetëm me vendim qeverie. Kuota ditore që ata marrin për shpenzime të vogla është 1 mijë lekë në muaj, dhe pretendimi ishte që kjo shumë të ishte të paktën 15 mijë lekë në muaj, pra 30 ditë x 50 lekë/dita.

Personeli dhe *Organika*

Personeli i këtij Institucioni përbëhej nga 22 punonjës gjithsej, nga të cilët: -1 drejtues, 1 psikolog, 1 punonjëse sociale, 6 specialistë edukatorë (të gjithë me arsim të lartë) dhe 6 kujdestarë, 1 Përgjegjës Administrate (i cili është edhe financier), 1 roje nate dhe mirëmbajtjes, 2 kuzhinierë dhe 3 sanitare.

Grup moshat që jetojnë në këtë institucion rezidencial e kanë shumë të nevojshme praninë edhe të një ndihmësmjeku, gjë e cila është kërkuar edhe në SHSSH, për tu shtuar në organikë.

Për sa më sipër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator
1-10 fëmijë- 1 mësues i arsimit profesional
1-20 fëmijë- 1 infermier
1-20 fëmijë- 1 mjek i përgjithshëm.

Asnjë nga kërkesat e standardeve nuk përmbushet.

Në fillim të çdo viti nga Drejtoria e institucionit bënte planin e trajnimeve, por më tepër trajnime duhen zhvilluar për stafin, dhe nga ana e SHSSH edhe duhen orientuar lidhur me procesin e trajnimeve, sipas kërkesave të kohës.

Kushtet materiale

Ngrohja realizohej me kaldajë me naftë.

Nga Bashkia Sarandë i është lënë hapësira e përdorimit të plazhit publik për këta fëmijë, por do të ishte më e frytshme që shtëpia e pushimit Borsh e cila varet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të shfrytëzohet nga fëmijët e këtij institucioni por edhe për fëmijët e tjerë të qendrave rezidenciale në Shqipëri.

Kutia e ankimit hapej me komision dhe çelësin e saj e kishte përfaqësuesja e sektorit social të Bashkisë Sarandë. Po ashtu në ambientet e Institucionit ishin të afishuara të drejtat e fëmijëve. Monitorimi i fundit i kryer nga Shërbimi Social Shtetëror për këtë institucion ishte i Tetorit 2015.

Blerjet kryheshin nga grupi multidisiplinor i Institucionit bazuar dhe në standardet e shërbimit social. Po ashtu në proces ishte miratimi i një projekti për rikonstruksionin e godinës së Institucionit nga TIKA (Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim).

Në procesin e transferimit të fëmijëve nga një institucion në një tjetër (pra kur mbushin moshën p.sh nga Shtëpia e Foshnjës fëmija kalon në Shtëpinë e Fëmijës së moshës shkollore) duhen kaluar përkatësisht edhe fondet. Pra procesi i transferimit të fëmijëve, duhet shoqëruar edhe me transferimin e fondit përkatës për secilin fëmijë.

Nevojitet ndjekja në vijimësi e procesit të rikonstruksionit të godinës (e cila është premtuar të kryhet nga donatorë të huaj), me synimin e përmirësimit të kushteve të jetesës së fëmijëve.

Problemi i ambienteve të kopshtit ditor, të zëna nga Bashkia Sarandë. Në funksion të kthimit në shtëpi-familje, këto ambiente i duhen këtij Institucioni për të rinjtë e moshës 16-18 vjeç. Kështu sallat e studimit që dikur ishin në këto ambiente, janë zhvendosur në katin e tretë (d.m.th në dhomat e gjumit të vajzave), dhe për pasojë vajzat janë vendosur nga katër në çdo dhomë ndërkohë që sipërfaqet e tyre janë shumë të vogla. Ndaj ambientet e kësaj shtëpie duhen rikonstruktuar për përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Sarandë si dhe përmbushjen e standardit Nr. 11 sipas të cilit "Shtëpia siguron mjedis fizik të përshtatshëm, mikpritës, të një stili shtëpiak dhe të një cilësie të mirë për fëmijët,

stafin, prindërit apo personat e tjerë të interesuar, në përputhje me qëllimin dhe funksionin e saj”.

Edukimi dhe aktivitetet

Arsimi fillor (klasat nga 1-5) ndiqej nga 20 fëmijë, dhe (klasat 5-X) ndiqeshin nga 22 fëmijë.

Shtëpia e Pushimit në Borsh, e cila është në varësinë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, konsiderohej shumë e frytshme të shfrytëzohet nga fëmijët e këtij Institucioni në stinën e verës, pra për interesin më të mirë të fëmijëve.

Nga ana e Fondacionit “Shpresë për Botën” janë ndihmuar shumë dhe lidhur me punën e diferencuar me fëmijët, për organizimin e mjaft aktiviteteve dhe ditëlindjeve të fëmijëve.

Në mënyrë që Shtëpia e Fëmijës Shkollor Sarandë, si institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët 6-18 vjeç të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në Institucionet Rezidenciale,

REKOMANDOJMË

1-Marrjen e masave që në procesin e transferimit të fëmijëve nga njëra qendër tek tjetra, brenda sistemit të SHSSH të shoqërohet edhe me fondin përkatës për secilin fëmijë.

2-Marrjen e masave nga Bashkia Sarandë për mbështetjen dhe fuqizimin ekonomik të familjeve me fëmijë të institucionalizuar, për përgatitjen e kthimit të tyre në familjen biologjike.

3-Marrjen e masave për trajnime për stafin e institucionit nga ana e SHSSH.

4-Përmbyllja sa më e shpejtë e rikonstruksionit të plotë të godinës, pasi situata aktuale e apartamenteve në pjesën e pasme të godinës është e amortizuar krejtësisht nga lagështira dhe e papërdorshme për asnjë aktivitet.

5-Rishikimi i kuotës ditore ushqimore, me synim rritjen e saj si pasojë e rritjes së çmimeve të produkteve që në vitin 2012, si dhe si pasojë e rritjes së moshës së qëndrimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror nga 16 vjeç në 18 vjeç.

6-Po ashtu në të njëjtën linjë edhe rritja e kuotës së shpenzimeve të vogla për fëmijët nga 1 mijë lekë në muaj, në të paktën 15 mijë lekë në muaj, pra 30 ditë x 50 lekë/dita.

7-Marrjen e masave për shfrytëzimin e Shtëpisë së Pushimit në Borsh, nga fëmijët e këtij Institucioni në stinën e verës, pra për interesin më të mirë të fëmijëve.

8-Marrjen e masave nga Bashkia Sarandë që ambientet e kopshtit ditor të zëna si dhe të Ndërmarrjes së Shërbimeve, t'i kthehen institucionit, në funksion të kthimit në shtëpi-familje, të këtyre ambienteve për të rinjtë e moshës 16-18 vjeç.

9-Marrjen e masave për shtimin në organikë të një ndihmësmjeku.

10. Shtëpia e Fëmijës 0-6 vjeç Durrës²⁷.

Gjatë vizitës inspektuese u këqyren kushtet materiale në të cilat jetojnë këto fëmijë, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, kuzhina, si dhe dokumentacioni i mbajtur nga stafi i institucionit në lidhje me aktivitetet që zhvillohen për këta fëmijë, kartelat mjekësore, dosjet psiko-sociale, shkollimi dhe edukimi i tyre. Gjithashtu, nëpërmjet bisedave dhe intervistave konfidenciale me fëmijët e grup-moshave të ndryshme, grupi inspektues u ndal veçanërisht në mbledhjen e të dhënave lidhur me trajtimin e tyre nga ana e stafit të këtij institucioni.

Aty trajtoheshin fëmijë nga mosha 0-6 vjeç, gjithashtu kryen edhe rolin e Qendrës Ditore.

Aktualisht nga 19 fëmijë rezidencialë që kishte gjithsej, 5 prej tyre janë në proces birësimi. Nuk ka jetimë biologjikë, por fëmijë të braktisur nga familje me probleme sociale.

Si *Qendër Ditore* trajton 27 fëmijë (5 fëmijë të moshës 6 vjeç; 11 fëmijë të moshës 5 vjeç; 10 fëmijë të moshës 4 vjeç), ndërkohë që kapaciteti është 25 fëmijë, pra me frekuentim ditor kryesisht nga familje me probleme ekonomike e për të cilët vendoset nga pushteti vendor frekuentimi i këtij Institucioni.

Fëmijët rezidenciale janë gjithsej 19 fëmijë ndërkohë që kapaciteti është 20 fëmijë për të treja shtëpitë-familje. 2 shtëpi-familje janë në Shkozë, Durrës dhe 1 shtëpi-familje në Durrës.

Një nga shtëpitë e Shkozë funksionon vetëm si Qendër Ditore Komunitare dhe nuk ka fëmijë rezidencialë për shkak të rikonstruksionit të godinës që po bëhet nga ana e donatorëve të ndryshëm si Vodafone Albania, Megatek, Alfabank etj. Projekti i këtyre qendrave ka qenë shtëpia në lagjen nr. 14 në Shkozë të funksiononte si Qendër Ditore Komunitare dhe dy shtëpitë e tjera si shtëpi-familje me kapacitet 7+2, të ndarë sipas grup moshave të fëmijëve. Aktualisht *Shtëpiza e Shkozë* ka 9 fëmijë (3 me interesim dhe 6 pa interesim), mosha e fëmijëve është 1 fëmijë 9 muajsh; 5 fëmijë 1 vjeç; 3 fëmijë 2 vjeç; si dhe *Shtëpiza Durrës* ka 10 fëmijë (8 me interesim dhe 2 pa interesim), mosha e tyre është 3 fëmijë 1 vjeç; 4 fëmijë 2 vjeç; 1 fëmijë 3 vjeç; 2 fëmijë 4 vjeç.

Ky Institucion ka varësi të dyfishtë: nga Bashkia Durrës, e cila emëron stafin dhe nga Shërbimi Social Shtetëror i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që

²⁷ Inspektim i datës 5.05.2016

akordon fonde nga buxheti i shtetit si dhe donacione. Monitorimi i standardeve në këtë qendër kryhej nga Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, si dhe inspektime nga Bashkia Durrës.

Kutia e ankesave ishte jashtë funksionit pasi nuk ishte përdorur asnjëherë nga ish drejtuesja e qendrës apo përfaqësuesja e sektorit social të Bashkisë Durrës.

Trajtimi

Gjatë inspektimit u evidentuan disa probleme në kontrollin e fëmijëve në Shtëpizën Durrës, pasi të 10 fëmijët që ishin edhe të moshave të ndryshme monitoroheshin nga ora 8.00-16.00 vetëm nga një kujdestare, duke bërë që këta fëmijë të jenë të ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe psikike të ushtruar nga punonjësit e këtij institucioni, ashtu sikurse edhe ka ndodhur pikërisht në këtë shtëpi-familje nga kujdestarja e këtij institucioni.

Gjatë inspektimit u vu re se shumë prej fëmijëve ndodheshin në katin e parë të shtëpisë, kurse katër fëmijë të tjerë ishin në dhomat e gjumit të katit të dytë duke qarë, por kujdestarja e kishte të pamundur t'i ofronte shërbim këtyre fëmijëve, pasi ishte duke ushqyer fëmijët e tjerë në katin e parë të shtëpisë.

Kuota ditore ushqimore, për fëmijët rezidencialë ishte 290 lekë në muaj për fëmijët 0-3 vjeç dhe 300 lekë në muaj për fëmijët 3-6 vjeç.

Fëmijët vizitoheshin si dhe takoheshin rregullisht nga të afërmit duke u monitoruar nga personeli i qendrës, duke bërë shënimin përkatës në librin e takimeve.

Personeli dhe Organika

Personeli i këtij Institucioni përbëhej nga 27 punonjës nga të cilët:

1 drejtues, 1 financier, 1 përgjegjës sektori social, 1 specialist sektori social, 17 kujdestarë (nga të cilët 2 me arsim të lartë dhe 15 me arsim të mesëm, 1 nga kujdestarët kryente rolin e infermierit), 2 kuzhinierë, 1 magazinier, 1 punëtor mirëmbajtje, dhe 1 sanitar, 1 mjek part-time, që paraqitej në qendër çdo ditë nga 2 orë. Gjithashtu me problemet psiko-sociale merren vetëm 2 punonjës socialë.

Për sa më sipër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog
1-5 fëmijë- 1 edukator
1-10 fëmijë- 1 infermier
1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Asnjë nga kërkesat e mësipërme të standardeve nuk përmbushen.

Nga Bashkia Durrës janë trajnuar drejtuesi i qendrës për zbatimin e masave ndaj rreziqeve si dhe në rastet e emergjencave civile; si dhe punonjësi social; lidhur me abuzimin seksual e fizik.

Por ka munguar trajnimi i stafit. Në fillim të çdo viti nga Drejtoria e institucionit hartohet plani i trajnimeve, por më tepër trajnime duhen zhvilluar për stafin, dhe nga ana e SHSSH edhe duhen orientuar lidhur me procesin e trajnimeve, sipas kërkesave të kohës.

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të pjesshme, neuro pediatre në spitalin rajonal Durrës, por mungonte ndihmësmjekja.

Sa i përket punonjësit të shërbimit (rojës), nuk kishte roje në organikën e kësaj qendre. Këtë shërbim e kryejnë vetë punonjësit e qendrës.

Kushtet materiale

Ngrohja në këtë qendër realizohej me kondicionerë, ngrohëse.

Përsa i përket zbatimit të masave ndaj rreziqeve si dhe në rastet e emergjencave civile, rezultoi që nga Bashkia Durrës janë trajnuar drejtuesi i qendrës dhe punonjësi social; lidhur me abuzimin seksual e fizik, por ka munguar trajnimi i stafit. Gjatë inspektimit u evidentuan edhe probleme në lidhje me kontrollin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimi. Stafi ishte i pa trajnuar, bombolat e zjarrfikëseve të pa kolauduara, ashtu sikurse edhe bombolat e gazit që përdoren për gatim.

Në ambientet e Institucionit ishin të afishuara të drejtat e fëmijëve, dhe ekzistonte kutia e ankesave e cila ishte pa çelës dhe jashtë funksionit pasi nuk ishte përdorur asnjëherë nga ish drejtuesja e qendrës apo përfaqësuesja e sektorit social të Bashkisë Durrës.

Të gjithë fëmijët ishin të pajisur me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti.

Vaksinimi i fëmijëve në këtë institucion kryhej rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të.

Në këtë institucion ndodheshin 3 fëmijë që mjekoheshin për Rhinit alergjik, mjekimi e të cilëve, por edhe e të gjithë fëmijëve që herë pas here kishin nevojë për trajtim medikamentoz, nuk zbatohet me receta të rimbursueshme, por ilaçet siguroheshin

me anë të një fondi financiar të posaçëm të institucionit të planifikuar në çdo fillim viti.

Kontrollet periodike mjekësore kryheshin rregullisht, si dhe ecuria e zhvillimit psikomotor të fëmijëve ishte e dokumentuar.

Nevojitej rikonstruksioni total i godinës, pasi situata aktuale e dy shtëpi-familjeve ku qëndrojnë aktualisht fëmijët rezidencialë është e amortizuar krejtësisht, ka lagështirë duke mos ofruar një shërbim më të mirë për një jetesë sa më të shëndetshme. Kështu kati i dytë qendrës sociale rezidenciale në lagjen 14 Shkozet, Durrës është riparuar nga Ambasada, ndërsa Vodafone Albania do të kryejë arredimin e ambienteve të brendshme, por duhet të merren masa të menjëhershme për rikonstruksionin total të kësaj qendre në funksion të kthimit në shtëpi-familje, të këtyre ambienteve.

Stafi ishte i pa trajnuar, bombolat e zjarrfikëseve të pa kolauduara, ashtu sikurse edhe bombolat e gazit që përdoren për gatim. Në të tre objektet hapësira përreth lejon kalimin e mjeteve të zjarrfikëseve, por mungojnë detektorët për tymin dhe sensorët e gazit në kuzhinë. Duhet të orientohen rrugët e evakuimit me sinjalistikën e duhur.

Në të tre objektet hapësira përreth lejon kalimin e mjeteve të zjarrfikëseve, por mungojnë detektorët për tymin dhe sensorët e gazit në kuzhinë. Duhet të orientohen rrugët e evakuimit me sinjalistikën e duhur.

Në mënyrë që Shtëpia e Fëmijës Durrës, si institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët 0-6 vjeç të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në Institucionet Rezidenciale,

R E K O M A N D O J M Ë

1-Marrjen e masave që në procesin e transferimit të fëmijëve nga një institucion në një tjetër (pra kur mbushin moshën p.sh nga Shtëpia e Foshnjës, fëmija kalon në Shtëpinë e Fëmijës së moshës shkollore) duhen kaluar përkatësisht edhe fondet. Pra procesi i transferimit të fëmijëve, duhet shoqëruar edhe me transferimin e fondit përkatës për secilin fëmijë.

2-Marrjen e masave për trajnimin e stafit për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimi, si dhe kolaudimin e bombolave të zjarrfikëseve si dhe të bombolave të gazit që përdoren për gatim, si dhe vendosjen e detektorëve të tymit e sinjalistikës për rastet e emergjencave.

3-Shtimin në organikën e këtij institucioni rezidencial të një ndihmësmjeku.

4- Marrja e masave të menjëhershme nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për shtimin e organikës së Shtëpizës së Durrësit me punonjës kujdestarë, pasi të 10 fëmijët që ishin edhe të moshave të ndryshme monitoroheshin nga ora

8.00-16.00 vetëm nga një kujdestare duke bërë që këta fëmijë të jenë të ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe psikologjike të ushtruar nga punonjësit e këtij institucioni.

5- Garantimi i të drejtës së ankimit duke vendosur një kuti ankesash të rregullt dhe me çelës.

6- Marrja e masave për rikonstruksionin total të godinës.

11. Shtëpia e foshnjës 0-6 vjeç, Shkodër²⁸

Konkretisht, gjatë inspektimit që përfaqësues të Institucionit tonë kryen në Shtëpinë e Foshnjës 0-6 Shkodër, dhe në takimin e bërë me drejtuesit e këtij institucioni, u informuam se aty trajtoheshin fëmijë nga mosha 0-6 vjeç, gjithashtu kjo qendër kryen edhe rolin e Qendrës Ditore. Kapaciteti i kësaj qendre ishte 35 fëmijë.

Aktualisht në këtë qendër ndodhen të akomoduar 8 fëmijë rezidenciale dhe 20 fëmijë që frekuentojnë qendrën ditore. Të 8 fëmijët rezidenciale janë nga familje me probleme sociale, pra me interesim të prindërve. Ndërkohë si Qendër Ditore trajton 20 fëmijë, pra me frekuentim ditor kryesisht nga familje me probleme ekonomike e për të cilët vendoset nga pushteti vendor frekuentimi i këtij Institucioni, plus 10 nëna të këtyre fëmijëve të cilat përfitojnë këshillim psiko-social.

Ky Institucion ka varësi të dyfishtë: nga Bashkia Shkodër, e cila emëron stafin dhe nga Shërbimi Social Shtetëror, i cili është institucion në varësi të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, që akordon fonde nga buxheti i shtetit. Drejtuesja e qendrës konfirmoi se ka një marrëveshje midis Qendrës, Bashkisë dhe Fondacionit “Shpresë për Botën”, për ndihmesë me donacione në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme.

Personeli i këtij Institucioni përbëhej nga 14 punonjës.

Monitorimi i standardeve në këtë qendër kryhej nga Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, si dhe inspektime nga Bashkia Shkodër.

Trajtimi

Nga bisedat konfidenciale me fëmijë të grup moshave të ndryshme, rezidenciale në këtë institucion, nuk u konstatua të kishte një tendencë nga ana e stafit të qendrës

²⁸ Inspektim i datës 18.04.2016

për dhunë fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve. Perceptimi i përgjithshëm që na u dha ishte clirësia e fëmijëve me stafin që kujdesej për to dhe afeksioni ndaj tyre.

Po ashtu fëmijët vizitoheshin si dhe takoheshin rregullisht nga të afërmit, por Shërbimi Social Shtetëror ka kërkuar që fëmijët të mos i dërgojnë nëpër familje pa pyetur punonjësit e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve, madje Bashkia Shkodër ka hartuar një procesverbal, ku prindi i fëmijës deklaron përpara drejtorit të institucionit që do të marrë fëmijën.

Personeli dhe Organika

Personeli i këtij Institucioni përbëhej nga 14 punonjës nga të cilët:

1 drejtues, 1 përgjegjës sektori finance, 1 përgjegjës sektori social, 8 kujdestarë (nga të cilët 4 me arsim të lartë dhe 4 me arsim të mesëm, 1 nga kujdestarët kryente rolin e infermierit), 1 magazinier, 1 punëtor mirëmbajtje, dhe 1 sanitar, 1 mjek me kohë të pjesshme, që paraqitej në qendër çdo ditë nga 2 orë. Pra sic konstatohet lehtësisht edhe nga përshkrimi i strukturës, ky institucion nuk ka edukatore. Gjithashtu me problemet psiko-sociale merret vetëm 1 punonjës social, por ishte e nevojshme emërimi i një psikologu, që është kërkuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkia Shkodër, por ende ky punonjës mungon në këtë qendër.

Për më tepër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 infermier

1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Standardet e sipërcituara për 1 mjek pediatër me kohë të plotë, 1 psikolog, edukator dhe 1 infermier nuk përmbushen nga ky institucion.

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjek me kohë të pjesshme, por mungonte ndihmës mjekja/ infermierja. Mjekja e këtij institucioni mbulonte si mjekje familjeje Qendrën Shëndetësore Nr. 3 të Shkodrës.

Të gjithë fëmijët ishin të pajisur me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti.

Vaksinimi i fëmijëve në këtë institucion kryhej rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të.

Gjithashtu në mënyrë rigoroze kryheshin kontrollet periodike mjekësore të fëmijëve, si dhe ecuria e zhvillimit psiko motor të tyre ishte e mirë dokumentuar.

Në këtë institucion ndodheshin 3 fëmijë që mjekoheshin për Rhinit alergjik dhe Anemi ferriprive, mjekimi e të cilëve, por edhe e të gjithë fëmijëve që herë pas here kishin nevojë për trajtim medikamentoz, nuk zbatoheshin me receta të rimbursueshme, por ilaçet siguroheshin blidheshin me anë të një fondi buxhetor të posaçëm të institucionit të planifikuar në çdo fillim viti.

Kushtet materiale

Godina në të cilën është e vendosur qendra, është godinë 2-katshe, e vjetër, dhe me lagështirë të theksuar në të gjitha ambientet. Ambientet e jashtme të godinës, oborri ishin të mirë sistemuar, me lodra dhe lulishte, ambient në të cilin zhvilloheshin shumë aktivitete. Në ambientet e brendshme të Institucionit ishin të afishuara të drejtat e fëmijëve. Në katin e parë kishte një dhomë fjetje për fëmijët e vegjël e ardhur mirë, e pajisur me kondicioner. Lavanteria ndodhej në kat të parë, e pajisur me 1 lavatriçe dhe një tharëse rrobash. Kuzhina e cila ndodhej po në kat të parë ishte përgjithësisht e pastër. Ky ambient ishte lyer dhe i ishin bërë instalime të reja elektrike një vit me parë. Menuja javore ishte e afishuar në mur. Librezat shëndetësore të kuzhinierëve ishin të përditësuara. Kampionët ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike, por jo të mbyllur me çelës. Kuota ditore ushqimore, për fëmijët rezidencialë, ishte 3100 lekë në muaj dhe ishte e mjaftueshme, dhe 1600 lekë për fëmijët ditorë të cilët kanë dy vakte të përfshira (mëngjes dhe drekë).

Në kat të dytë të godinës ndodhej Qendra Ditore si dhe dhoma e takimit me prindërit. Po në këtë kat kishte një dhomë gjumi për fëmijët e qendrës ditore dhe një tualet po për këta fëmijë por nuk kishte post dushi. Tavani i katit të 2-të kishte një lagështirë të theksuar.

Ngrohja e fëmijëve në këtë qendër realizohej me kondicionerë, ngrohëse dhe nuk paraqiste problem.

Përsa i përket zbatimit të rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, rezultoi që nga Bashkia Shkodër janë trajnuar drejtuesi i qendrës dhe punonjësi social, lidhur me abuzimin seksual e fizik, por ka munguar trajnimi i stafit. Gjatë inspektimit u evidentua se nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkia Shkodër duhet të kryejnë trajnime për stafin (kujdestarët dhe infermierët) me metoda bashkëkohore për punën me fëmijët.

Institucioni ishte pajisur me 2 bombola kundër zjarrit dhe stafi ishte trajnuar për reagimin ndaj ndonjë rasti emergjent.

Gjithashtu kushtet e strehimit dhe furnizimi me artikuj të dhomave të gjumit, të gatimit, etj., ishin në parametra normale, por ishte e domosdoshme pajisja e dhomave të gjumit me çarçafë dhe batanije, si dhe me karrige për fëmijët e vegjël, pasi ato ishin të amortizuara. Gjithashtu, u evidentua se furnizimi me artikuj hotelerie (pampers e detergjente), që realizohej nga Buxheti i Shtetit, ishte i pakët dhe kërkohej shtimi i tyre.

Sa i përket punonjësit të shërbimit (rojës), këtë rol e kryen punonjësi i mirëmbajtjes. Institucioni nuk kishte një automjet që të mund të mbulonte lëvizjen e fëmijëve.

Edukimi dhe aktivitetet

Nga dokumentacioni i kontrolluar Sektorit Psiko-Social rezultoi se kjo qendër kryente aktivitete të ndryshme ditore brenda institucionit si dhe jashtë tij. Planet e aktiviteteve ishin mujore, me data të përcaktuara për secilin aktivitet. Institucioni kishte të ngritur një grup multidisiplinar për vlerësimin e nevojave të fëmijëve. Nga ana e Fondacionit “Shpresë për Botën” organizohen shpesh aktivitete të ndryshme si: ditëlindje të fëmijëve dhe 1 herë në muaj ata shoqërohen për t’u argëtuar në kënde lojërash. Kutia e ankesave ishte e vendosur në ambientet e institucionit, e kyçur, çelësin e së cilës e mbante Shërbimi Social Shtetëror Rajonal dhe sipas Rregullores ajo hapej me procedurë të përcaktuar, me komision.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetës e zhvillimit të këtyre fëmijëve duhet të jetë i një rëndësie të veçantë, nisur dhe nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Kjo në funksion të garantimit të rritjes së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore.

Sa më lart megjithëse në kuadrin e decentralizimit të shërbimeve shoqërore e për t’iu përgjigjur sa më mirë nevojave të mirërritjes, mirë edukimit e zhvillimit të këtyre fëmijëve po ju drejtohem bashkërisht si Bashkisë ashtu dhe Shërbimit Social Shtetëror.

Në mënyrë që ky institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

1. *Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së këtij institucioni me 1 mjek peditër me kohë të plotë, 1 psikolog, edukator dhe 1 infermier në përputhje me standardet²⁹.*
2. *Marrjen e masave për plotësimin e organikës së këtij institucioni të një infermieri me kohë të plotë.*
3. *Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së këtij institucioni me një punonjës të shërbimit roje, rregullim i cili në qendrat e tjera realizohet me roje private, por kjo qendër nuk kishte fonde.*
4. *Marrjen e masave për dhënien prioritet shërbimeve të tjera alternative, siç është procesi i marrjes në kujdestari të fëmijëve nga familjet kujdestare, në zbatim të legjislacionit në fuqi³⁰.*
5. *Marrjen e masave për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të këtij institucioni, kryesisht mbi tematika për mbrojtjen dhe parandalimin e çdo lloj dhune, fizike apo psikike ndaj fëmijëve.*
6. *Marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e një fondi të veçantë për blerjen e një automjeti, pasi fëmijët e vegjël (foshnje) kanë nevojë të mëdha për shoqërim.*
7. *Marrjen e masave të menjëhershme për parashikimin në buxhetin e vitit pasardhës të një fondi shtesë për restaurimin e ambienteve të brendshme dhe çatisë të këtij institucioni.*

12. Shtëpia e Fëmijës parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër³¹

Shtëpia e Fëmijës Parashkollorë 3-6 vjeç, me një kapacitet zyrtar prej 30 fëmijësh, në momentin e inspektimit kishte 19 fëmijë, 8 prej të cilëve ishin mbi moshën 6 vjeç. Këta fëmijë nuk ishin të ndarë sipas grup moshave pasi shumë prej tyre ishin motra dhe vëllezër, ndaj dhe institucioni kishte gjykuar si më të drejtë një ndarje të tillë. Të gjithë fëmijët ishin të pajisur me dosje pranimi nga Shërbimi Social Shtetëror, ndërsa për tre fëmijët e kësaj shtëpie kishin nisur procedurat e birësimit.

Organika e këtij institucioni ishte e përbërë nga 18 punonjës.

Fondet me të cilat mbahet ky institucion vijnë nga buxheti i shtetit, Shërbimi Social Shtetëror, por edhe nëpërmjet donacioneve kryesisht nga Fondacioni “Shpresë për Botën”, i cili ka një marrëveshje me institucionin.

²⁹ VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

³⁰ Vendim Nr. 89, Datë 26.1.2012 “Për Përcaktimin e Kritereve, të Dokumentacionit dhe të Procedurës së Shërbimit të Kujdestarisë”

³¹ Inspektim i kryer me datë .18.04.2016

Ky është i vetmi institucion rezidencial për fëmijët, në qytetin e Shkodrës i cili ka varësi direkte vetëm nga Shërbimi Social Shtetëror.

Monitorimi i standardeve në këtë qendër kryhej nga Shërbimi Social Shtetëror në mënyrë periodike.

Trajtimi

Nga bisedat konfidenciale me fëmijë të grup moshave të ndryshme, rezidenciale në këtë institucion, u konstatua se kishte një tendencë për të mos treguar apo “spiunuar” siç u shprehën ata vetë në lidhje me sjelljen dhe trajtimin e kujdestareve ndaj fëmijëve. Ata dëshmuar se dënoheshin nga kujdestaret kur bënin gabime, të vendosur me fytyrë nga muri, me një këmbë të ngritur. Nga ana e grupit inspektues u konstatua se kishte perceptim të përgjithshëm të presionit psikologjik ndaj këtyre fëmijëve. Përsa i përket dhunës fizike ndaj tyre, si shkulje të flokëve dhe tërheqje veshi, u përmend emri i kujdestares së pushuar nga puna Edvana Sula, situatë e ndodhur kjo në kohën kur kjo punonjëse ishte pjesë e stafit të këtij institucioni.

Përsa i përket të drejtës së takimit me prindërit, fëmijëve iu mundësohej takimi i rregullisht me prindërit, të afërmit, madje institucioni ofronte akomodim me fjetje për nënat e tyre.

Personeli dhe Organika

Organika e këtij institucioni ishte e përbërë nga 18 punonjës, nga të cilët një pozicion me profesion kujdestar ishte ende i paplotësuar. Aktualisht stafi i kësaj shtëpie përbëhej nga:

- 1 drejtues
- 14 punonjës në sektorin e Shërbimit Social, nga të cilët 1 punonjës social Përgjegjës Sektori, 5 specialistë edukatorë (të gjithë me arsim të lartë, Dega Cikël i Ulët dhe Cikël Parashkollor) dhe 8 kujdestarë (6 me arsim të mesëm dhe 2 me arsim të lartë);
- 3 punonjës në Sektorin e Administratës, nga të cilët një përgjegjës sektori dhe 2 kuzhinierë. Në këtë institucion mungon psikologu, megjithëse është bërë disa herë kërkesë për shtim të këtij pozicioni pune në organikë. Kujdestaret dhe edukatoret bënin 40 orë punë në javë por kanë 1 ditë pushim. Shoferi i institucionit kryen edhe mirëmbajtjen. Puna zhvillohet me tre turne. Gjatë turnit të natës caktoheshin dy kujdestar, një për çdo grup. Në strukturë nuk kishte një punonjës të caktuar për luanterinë dhe një sanitar.

Për sa më sipër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 infermier

1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Nga detajimi i strukturës del e qartë se jo të gjitha kërkesat e standardeve përmbushen.

Nga verifikimi i dosjeve të personelit rezulton se pjesa më e madhe e punonjësve të këtij institucioni kanë një kohë relativisht të gjatë të punësuar aty, gjë e cila është për tu vlerësuar. Këta punonjës janë rekrutuar në zbatim të Kodit të Punës së R. Sh, si dhe një procedure të përcaktuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Të gjithë punonjësit e këtij institucioni, kishin Kontrata Individuale Pune, të rinovuar që prej vitit 2013, si dhe dokumentacionin përkatës, përfshi këtu, dëshmitë e penalitetit, raportet mjeko-ligjore, certifikata trajnimesh të ndryshme etj.

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me anë të një mjekeje me kohë të pjesshme, pediatre në spitalin rajonal Shkodër, por mungonte ndihmës mjekja/infermierja. Kartat e shëndetit për të gjithë fëmijët e këtij institucioni siguroheshin nga mjekja e familjes së lagjes “Tre Heronjtë”, e cila gjithashtu, zbatonte me receta të rimbursueshme, mjekimet të cilat i rekomandonte mjekja pediatre e institucionit. Në këtë institucion, të gjitha kontrollet periodike mjekësore, vizitat tek okulisti, si dhe stomatologu kryheshin sipas standardeve dhe me rigorozitet. Gjithashtu të mbajtura me rregull ishin edhe regjistrat, kartelat mjekësore që administronte mjekja pediatre e kësaj shtëpie.

Kushtet materiale

Godina e Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor 3-6 vjeç, Shkodër, ishte 2-katshe. Në oborrin e institucionit ishte ndërtuar salla e lojërave, me donacion të FI-Bank. Oborri i institucionit kishte hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, ku fëmijët luanin sipas një plani ditor, të shoqëruar nga edukatorët. Kutia e ankesave, e cila ndodhej në korridorin e katit të parë e kyçur me çelës dhe e aksesueshme për fëmijët, hapej çdo muaj nga përfaqësues të Shërbimit Social Shtetëror. Të drejtat e fëmijëve ishin të afishuara në stenda.

Në po këtë kat, djathtas ndodhej dhoma e fëmijëve më të vegjël në moshë. Kuzhina e cila ndodhej pranë mensës ku ushqeheshin fëmijët aneksit të ngrënies, ishte e pajisur me 2 soba gatimi dhe 2 frigoriferë. Librezat shëndetësore të kuzhinierëve ishin të përditësuara. Kampionët ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike, por jo të mbyllur me çelës. Kuota ditore ushqimore për fëmijët rezidencialë ishte 310 lekë në ditë dhe sipas stafit kjo kuotë ishte e mjaftueshme.

Në kat të parë ndodhej dhe një dhomë aktivitetesh, e cila deri një vit më parë përdorej për fëmijët e qendrës ditore.

Një problematikë evidente sa i përket infrastrukturës së këtij institucioni ishte lagështira e theksuar në ambientet e brendshme të godinës.

Lavanderia, e cila gjendej në katin e parë të godinës ishte e pajisur me 2 lavatriçe dhe 1 tharëse rrobash, por jo funksionale. Megjithatë, nga ana e stafit u ngrit si shqetësuese pamjaftueshmëria e tyre për të përballuar fluksin të larjeve të rrobave të fëmijëve, pasi 1 tharëse dhe 2 lavatriçe të tjera janë të prishura.

Në katin e dytë të godinës, ndodheshin dhomat e banimit të djemve dhe e vajzave, ku flinin përkatësisht 6 djem dhe 3 vajza.

Ngrohja e fëmijëve në këtë qendër realizohej me kondicionerë dhe nuk kishte shfaqur probleme gjatë dimrit. Tualetet dhe dushet ishin përgjithësisht të pastër dhe të rregullt por ato ishin të përbashkëta për vajzat dhe djemtë. Sipas stafit, fëmijëve iu mundësoheshin dushet 2 herë në javë gjatë muajve të dimrit dhe më shpesh gjatë muajve të verës. Edhe në këtë kat kishte një mensë për ushqyerjen e fëmijëve. Gjithashtu kushtet e strehimit dhe furnizimi me artikuj të dhomave të gjumit, të gatimit, etj) ishin në parametra normale.

Dhoma e takimi të prindërve me fëmijët ishte e mirë arreduar dhe e përshtatshme për të kryer një funksion të tillë.

Ky institucion nuk një shkallë emergjence, për daljen e fëmijëve dhe stafit në raste rënie zjarri. Stafi nuk ishte i trajnuar për përdorimin e tyre, por na u përgjigjën që dinin ti përdornin në rast se do të ishte e nevojshme. Në korridoret e të dy kateve të institucionit, ishin të vendosura bombolat kundra zjarrit, por të pakoaliduara.

Edukimi dhe aktivitetet

Nga ana e Fondacionit “Shpresë për Botën”, ky institucion ishte ndihmuar shumë lidhur me punën e diferencuar me fëmijët, për organizimin e mjaft aktiviteteve apo ditëlindjeve të fëmijëve. Ndhmesë të madhe këtij institucioni i jepej edhe nga shkolla jopublike “Pjetër Meshkalla”, e cila kryente çdo javë aktivitete për fëmijët. Gjithashtu një punë e konsiderueshme ishte bërë edhe përsa i përket aftësisimit të fëmijëve për integrim në komunitet të tyre apo kthimit në familje. Nga grupi inspektues u këqyrën dosje individuale të fëmijëve, të cilat ishin të plotësuara sipas standardeve.

Kutia e ankesave ishte e vendosur në ambientet e institucionit, e kyçur, çelësin e së cilës e mbante Shërbimi Social Shtetëror Rajonal dhe sipas Rregullores ajo hapej me procedurë të përcaktuar, me komision.

Raporti i Vlerësimit të Nevojave dhe Ecurisë-(RVNE), plotësoheshin dy herë në vit.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetës e zhvillimit të këtyre fëmijëve duhet të jetë i një rëndësie të veçantë, nisur dhe nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, kjo në funksion të garantimit të rritjes së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore.

Në mënyrë që ky institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,

REKOMANDOJMË

1. *Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e çdo lloj presioni psikologjik ndaj fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Parashkollor në Shkodër si dhe marrjen e masave disiplinore/administrative ndaj stafit të institucionit të cilët për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve janë përgjegjës për ushtrimin e dhunës psikologjike ndaj fëmijëve të kësaj shtëpie.*
2. *Marrjen e masave për shtimin në organikën e institucionit të një juristi për të për të treja Shtëpitë e fëmijës në qytetin e Shkodrës,*
3. *Marrjen e masave për plotësimin e stafit të këtij institucioni, konkretisht të psikologut, mjekut pediatër dhe të infermierit me kohë të plotë sipas standardeve³².*
4. *Marrjen e masave për plotësimin e stafit të këtij institucioni, si një punonjësi shërbimi, sanitari dhe punonjësi luanterie, pasi punën e tyre janë të detyruar ta kryejnë stafi ekzistues.*
5. *Marrjen e masave për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të këtij institucioni, kryesisht mbi tematika për mbrojtjen dhe parandalimin e çdo lloj dhune, fizike apo psikike ndaj fëmijëve.*
6. *Marrjen e masave për dhënien prioritet shërbimeve të tjera alternative, siç është procesi i marrjes në kujdestari të fëmijëve nga familjet kujdestare, në zbatim të legjisllacionit në fuqi³³.*

³² VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

³³ Vendim Nr. 89, Datë 26.1.2012 “Për Përcaktimin e Kriteve, të Dokumentacionit dhe të Procedurës së Shërbimit të Kujdestarisë

7. *Marrjen e masave për ndërtimin e shkallës së emergjencës si dhe trajnimin e stafit për përdorimin e bombolave kundër zjarrit.*
8. *Marrjen e masave për rregullimin e kushteve materiale të tualeteve si dhe ndarjen e tyre dhe të dusheve midis vajzave dhe djemve tek ambientet e casa-familjes, me synimin e përmirësimit të kushteve të jetesës së fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës Parashkollor në Shkodër.*

13. Shtëpia e Fëmijës Shkollor 6-18 vjeç, Shkodër³⁴

Gjatë vizitës inspektuese u këqyrën kushtet materiale në të cilat jetojnë këta fëmijë, ambientet e përbashkëta, shërbimet e ofruara, si dhe dokumentacioni i mbajtur nga stafi i institucionit në lidhje me aktivitetet që zhvillohen për këta fëmijë, kartelat mjekësore, dosjet psiko-sociale, shkollimi dhe edukimi i tyre sipas standardeve, të detajuara në VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”. Në vijim të inspektimit, të datës 19.04.2016, të kryer në Shtëpinë e Fëmijës Shkollore (6-18 vjeç), Shkodër, u informuam se aty akomodoheshin 35 fëmijë, kundrejt një kapaciteti zyrtar deri në 70 fëmijë. Një nga fëmijët ishte jetim biologjik, kurse pjesa tjetër janë me interesim nga të paktën njëri nga prindërit. Fëmijët janë nga qytetet të ndryshme të vendit dhe 10 prej tyre kanë edhe motrat ose vëllezërit në këtë institucion.

Ky Institucion ka varësi të dyfishtë: nga Bashkia Shkodër, e cila emëron stafin dhe nga Shërbimi Social Shtetëror, i cili është institucion në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që akordon fonde nga buxheti i shtetit. Drejtuesja e qendrës konfirmoi se ka një marrëveshje midis Qendrës, Bashkisë dhe Fondacionit “Shpresë për Botën”, për ndihmesë me donacione në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme.

Personeli i këtij Institucioni përbëhej nga 24 punonjës.

Monitorimi i standardeve në këtë qendër kryhej nga Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, si dhe inspektime nga Bashkia Shkodër.

Trajtimi

Avokati i Popullit si një institucion që mbron të drejtat dhe interesat e ligjshme të qytetarëve kur ato çënohen nga veprimet apo mosveprimet e parregullta të administratës publike si dhe duke pasur parasysh legjislacionin shqiptar dhe aktet

³⁴ Inspektim i kryer me datën 19.04.2016 dhe 25.04.2016

ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, si nenet 19 dhe 20 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve³⁵, nenet 5 dhe 10 të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual³⁶, nenin 54³⁷ të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë si dhe aktet ligjore dhe nënligjore që mbulojnë këtë fushë, gjatë monitorimit të kësaj qendre u ndal veçanërisht edhe në mbledhjen e të dhënave, lidhur me trajtimin e fëmijëve të grupmoshave të ndryshme nga ana e stafit të këtij institucioni.

Nga bisedat konfidenciale me fëmijët u dëshmuar se ata dënoheshin nga kujdestaret, të vendosur me fytyrë nga muri, me njërën këmbë të ngritur. Gjatë intervistimit ata u shprehën se kishte pasur raste të dhunës fizike dhe psikologjike të ushtruar nga njëra prej edukatoreve, si dhe nga dy djemtë e psikologes së këtij institucioni, ndaj disa prej fëmijëve rezidentë. Nga ana e grupit inspektues u konstatua gjithashtu se kishte perceptim të përgjithshëm të presionit psikologjik ndaj këtyre fëmijëve. Grupi inspektues këto dëshmi ia raportoi Avokatit të Popullit, i cili nëpërmjet grupit hetimor të ngritur prej tij kreu një hetim të pavarur administrativ, hetim i cili është realizuar më datë 25.04.2016.

Hetimi i pavarur administrativ u krye brenda të gjithë kuadrit ligjor e procedural për marrjen në pyetje të të miturve. Kështu, në marrjen e shpjegimeve të lira të fëmijëve

³⁵ Në nenet 19 dhe 20 të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Mbi të drejtat e fëmijës" datë 20 Nëntor 1989, parashikohet se: "Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimin të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, në se duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore. Një fëmije, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti. Shtetet Palë sigurojnë për këtë fëmijë një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. Kjo përkujdesje alternative mund të ketë, inter alia, formën e vendosjes në një familje, të "Kafalasë" sipas të drejtës islamike, të birësimit ose, në rast nevojë, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Në gjetjen e këtyre zgjidhjeve, duhet të mbahen mirë parasysh dëshira për vazhdimësinë në edukimin e fëmijës, si dhe origjina e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.

³⁶ Konventa është miratuar dhe hapur për nënshkrim në vitin 2007 me rastin e Konferencës së 28- të të Ministrave Evropianë të Drejtësisë në Lanzarote, Spanjë. Konventa hyri në fuqi më 1 korrik 2010. Shteti Shqiptar e ka ratifikuar Konventën më 14 Prill 2009, dhe hyri në fuqi më 1 Korrik 2010. Neni 5 i kësaj Konvente parashikon: 1. Secila palë do të marrë masa të domosdoshme legjislative dhe masa të tjera për të inkurajuar rritjen e njohurive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve midis personave që kanë kontakte të rregullta me fëmijët në arsim, shëndetësi, mbrojtjen sociale, në sektorët gjyqësorë të zbatimit të ligjit dhe në fusha që lidhen me sportin, kulturën dhe pikat e argëtimit.

2. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme legjislative dhe masat e tjera për të siguruar se personat, që përmenden në paragrafin 1, të kenë njohuri të përshtatshme për shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve, të mjeteve për të identifikuar ato dhe mundësinë përmendur në nenin 12, paragrafi 1.

3. Secila palë do të marrë masat e domosdoshme ligjore dhe masa të tjera, në përputhje me ligjin e saj të brendshëm, për të garantuar se kushtet për t'u futur në këto profesione, ushtrimi i të cilave nënkupton kontakte të shumta me fëmijët garantojnë që kandidatët për këto profesione të mos kenë qenë të dënuar për akte të shfrytëzimit seksual apo abuzimit seksual të fëmijëve.

Në pikën 1 të nenit 10 të po kësaj konvente parashikohet se: Secila palë do të marrë masat e domosdoshme për të siguruar bashkërendimin në nivel kombëtar ose vendor midis agjencive të ndryshme që përgjigjen për mbrojtjen nga; parandalimin dhe luftën kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve, përkatësisht sektori i arsimit, sektori i shëndetësisë, shërbimet sociale dhe autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore.

³⁷ Neni 54 i Kushtetutës së R.SH parashikon se: "Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojnë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën e zhvillimin e tij normal".

të realizuar nga Ndihmës komisionerët e Avokatit të Popullit, përveç juristëve dhe një mjeku psikiatër, grupi inspektues u asistua edhe nga një psikologe e cila punonte në Shkollën 9 vjeçare “Xheladin Fishta” në qytetin e Shkodrës.

Pavarësisht kushteve normale të krijuara në një nga mjediset e Shtëpisë së Fëmijës së këtij qyteti, konstatoam hezitim dhe frikë tek fëmijët e mitur, kjo dhe për faktin se pas inspektimit të kryer nga Ndihmës komisionerët e Avokatit të Popullit më datë 19 Prill 2016, ata ishin thirrur nga edukatorë dhe drejtori i institucionit duke iu bërë presion për shpjegimet e dhëna. Ky qëndrim u reflektua edhe gjatë marrjes së shpjegimeve të nxënëses Xh.N, në intervistimin e realizuar tek zyra e drejtorit të shkollës 9 vjeçare “Xheladin Fishta” në prani të psikologes së kësaj shkolle.

Në shpjegimet e tij të datës 25.04.2016, shtetasi i mitur me inicialet F.T, i datëlindjes 17.07.2000 deklaroi se “...kam dijeni për dhunën fizike të ushtruar nga edukatorja *Rafaela Canaj ndaj fëmijës S.G, i moshës 9 vjeç. Kjo ngjarje e ndodhur në Janar 2016, në kohën kur fëmija ishte bërë synet (cirkumcisio) dhe ishte akoma me plagë. S.G., erdhi dhe më takoi vetë në korridor dhe më tha se i ka rënë zyshë Rafaela me shkop të karriges tek plaga (organi gjenital ku ishte kryer ndërhyrja kirurgjikale) dhe ishte gjakosur (kishte patur hemorragji). Ky veprim ishte bërë tek një nga dhomat e mësimit, në prani të fëmijve të tjerë të mitur. Të nesërmen për këtë veprim i kam thënë drejtorit Gëzim Mahmutaj në zyrën e tij dhe ai më tha se e ka për të mirën e vet. Në fillim të vitit 2015, në kohën kur drejtore e Shtëpisë së Fëmijës ishte Albana Llazani, një ditë një fëmijë tjetër i kësaj shtëpie, Sh (Sh.H, aktualisht rezidente në Shtëpinë e Fëmijës Sarandë) është larguar nga shtëpia dhe kur erdhi të nesërmen më tha duke qarë se, djali i madh i drejtoreshës e kishte rrahur. Veç sa sipër, kam vënë re se zyshat, (edukatorët) ju kërkojnë fëmijëve të vegjël 10-12 vjeç, për të pastruar korridoret dhe banjat, si djemve ashtu edhe vajzave. Gjithashtu kam për të thënë se psikologja sjell shpesh në Shtëpinë e Fëmijës djalin e saj 14 vjeçar që quhet B, i cili sillet keq me fëmijët duke i goditur dhe me shpulla.*

Kur jam kthyer nga Tirana, ku kam qenë për vizitë pranë familjes time, shoku im D.J. që është 13 vjeç më tha se gjatë një ekskursioni në Razëm kishte parë B, djalin e Albanës që ngacmonte (të miturën) Xh.K, 12-13 vjeç”.

Shtetasi D.J, i datëlindjes 27.10.2002, në shpjegimet e tij të datës 25.04.2016, deklaroi ndërmjet të tjerave se: “ *Kam dijeni se para dy vjetëve, mund të ketë qenë muaj vere, kur një ditë F.T., që është shoku im më tregoi një video në celularin e tij ku zysh Rafaela godiste A.Q-në 13 vjeç tek klasa e mësimit, me shkop në trup dhe ai qante e bërtiste. Sipas D.J, F.T-së i kishte humbur aparati i telefonit.*

Mund të ketë qenë aty nga muaji Janar 2016, kur një ditë ka ardhur S.G, i cili i tha F.T, se Rafaela e kishte qëlluar tek plaga (organi gjenital ku ishte kryer ndërhyrja kirurgjikale), pasi ishte bërë synet dhe i kishte dalë gjak nga plaga, të cilin e pashë dhe vetë se po i rridhte gjak nëpër këmbë.

Në Shtëpinë e Fëmijës kam parë se zysh Albana sjell dy fëmijët e saj dhe djali më i vogël B ka ardhur në Velipojë dhe Razëm kur kemi shkuar ekskursion. Në Razëm

kemi shkuar më 1 Qershor 2015, kur kam parë Bekimin që ngacmonte Xh. K, 12 vjeç, duke qenë të zhveshur nga mesi e poshtë, të dy. Kjo ka ndodhur tek një shtëpi e vjetër dhe unë i pashë pasi i ndoqa nga prapa”.

Në shpjegimet e datës 25.04.2016, shtetasi i mitur A.Q, datëlindjes 19.03.2002, ndërmjet të tjerave deklaroi se: *“..kur ishte 8-9 vjeç ishte i sëmurë dhe nuk bënte detyrat dhe zysh Rafaela e nxori nga klasa. Mandej e thirri tek një klasë tjetër (quhet kompani). Kishte të fshehur prapa një shkop, më kapi për dore dhe më çoi tek dushet, e mbylli derën dhe më gjuajti me shkop. Pasi më ra me shkop në trup, më mori me të mirë dhe më tha hajde mos qaj”.*

Gjatë hetimit administrativ, më datë 28 Prill 2016, i janë marrë deklarime dhe shtetases F. G, nëna e shtetasit të mitur S.T, e cila sqaron se në periudhën e muajit Janar apo Shkurt 2016, me një mjek privat ka operuar djalin e saj S.G, në organin gjenital dhe për këtë e ka mbajtur në shtëpinë e saj në Tiranë për disa ditë. Sipas saj, djali S.G, ishte ankuar që kishte patur dhimbje në organin gjenital dhe kishte kërkuar ndihmë tek edukatore, por ato nuk e kishin ndihmuar duke i thënë që ta lagte me ujë të ftohtë organin gjenital. Po ashtu, djali S.G, ishte ankuar tek nëna e tij F. G se rrihej shpesh prej njëri nga fëmijët më të rritur në Shtëpinë e Fëmijës.

Për sa më sipër u konkludua se:

Së pari: Dy djemtë e ish drejtoreshës së Shtëpisë së Fëmijës Albana Llazani, kishin liri hyrje-dalje në Shtëpinë e Fëmijës, si dhe në rast ekskursionesh të organizuara në Velipojë dhe Razëm, ata merrnin pjesë në këto aktivitete. Duke qenë jashtë kontrollit të saj, ata kishin ushtruar dhunë fizike ndaj fëmijëve dhe në raste të tjera djali B. L kishte ngacmuar seksualisht fëmijët e seksit femër me moshë më të vogël se ai.

Së dyti: Nga edukatoret e Shtëpisë së Fëmijës në mënyrë flagrante, fëmijët e mitur me moshë 10-12 vjeç ishin vënë me detyrim të lanin korridoret dhe banjat e institucionit, veprim ky që bie ndesh dhe me pikë 3 të nenit 54 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Së treti: Nga edukatoret Rafaela Canaj etj, ishte ushtruar dhunë fizike duke i rrahur me këmbë të karrigeve, fëmijët e mitur si S. A., etj.

Së katërti: Në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër, personeli manifeston sjellje e qëndrime diskriminuese ndaj fëmijëve të komuniteteve rome apo egjiptianë, veprim ky i konfirmuar nga deklaratimet e të miturit F.T.

Nga analiza në tërësi e rastit, rezulton se punonjësit e Shtëpisë së Fëmijës Shkodër, ish drejtoresha Albana Llazani, e cila në momentin e hetimit mbante pozicionin e punës psikologe, Rafaela Canaj me detyrë edukatore etj, në kryerjen e funksioneve publike në tyre të detyrës shtetërore, me mosveprimet dhe veprimet e tyre të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mos përmbushje të rregullt të detyrës kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetasve, fëmijëve të mitur të atij institucioni. Ka një lidhje shkakësorë të drejtpërdrejtë midis veprimit dhe mosveprimit të kundërligjshëm, mos përmbushje të rregullt të detyrës dhe dëmtimit të interesave të

ligjshëm të shtetasve, me pasoja në dëm të shëndetit të tyre apo atij moral në rastet e ngacmimeve seksuale.

Me qëllim kryerjen e një hetimi të gjithanshëm institucioni i Avokatit të Popullit me anë të shkresës nr. K1/I51-4, datë 06.05.2016, i rekomandoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër *“Fillimi i hetimit në ngarkim të shtetaseve Albana Llazani, Rafaela Canaj, etj punonjës në Qendrën Rezidenciale të Fëmijëve Shkollorë 6-18 vjeç, Shkodër, persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”*.

Kushtet materiale

Ky institucion kishte një Rregullore të Brendshme (e vitit 2014) e miratuar nga Bashkia dhe SHSSH, kopje e së cilës u administrua nga stafi inspektues. Pra varësia ishte e dyfishtë si nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ashtu dhe nga Bashkia Shkodër. Konkretisht nga Bashkia kryhej emërimi i personelit dhe i drejtuesit, ndërsa komisionimet e fëmijëve kryhen nga SHSSH dhe nga MMRS e cila akordon buxhetin përkatës për këtë institucion. Gjithashtu kanë pasur ndihma dhe mbështetje nga donatorë të ndryshëm, nga të cilët spikat fondacioni “Shpresë për Botën”, i cili çdo vit jep ndihmat e tij me bazë materiale e artikuj të ndryshëm, si dhe në organizim aktiviteteve për argëtimin e fëmijëve. Planet për artikujt e donacioneve mirë koordinoheshin me drejtuesit e institucionit, në mënyrë që të plotësoheshin nevojat e përditshmërisë së përfituesve të këtij Institucioni me sa më shumë efektshmeri.

Shërbimi me roje i institucionit ishte i mbuluar 24 orë/ditë. Ky lloj shërbimi roj konsiderohet shumë i nevojshëm për shërbimet ndaj fëmijëve në këtë institucion rezidencial.

Sistemi i ngrohjes realizohej me kaldajë me naftë për gjithë vitin. Ambientet e studimit ishin të pajisura me kondicionerë si dhe me donacione kishin siguruar dhe panele diellore për dushet në tualete. Në këtë drejtim, institucioni i kishte të mbuluara më së miri nevojat.

Kuota ditore ushqimore ishte 330 lekë dhe kuotë mujore 1000 lekë, por na u konfirmua se nuk ishte e mjaftueshme, kjo pasi mosha e fëmijëve është rritur deri në 18 vjeç.

Nga ana e grupit monitorues, u inspektua kuzhina e institucionit e cila ishte e pastër dhe e rregullt. Kampionët ushqimor mbaheshin në kushte frigoriferike, por jo te mbyllur në çelës.

Ky institucion inspektohej rregullisht nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, e cila kishte lënë rekomandim për ndërtimin e një shkalle emergjence. Por nga ana e drejtorit të institucionit na u konfirmua se nuk kanë fonde për këtë. Bombolat kundër zjarrit ishin të kolauduara, të vendosura në korridoret e çdo kati.

Stafi nuk ishte i trajnuar për përdorimin e tyre, por na u përgjigjën që dinin ti përdornin në rast se do të ishte e nevojshme.

Furnizimi me artikuj të ndryshëm ishte i kënaqshëm, veshjet e fëmijëve bliheshin një herë në vit me fondet e buxhetit të shtetit, si dhe falë mbështetjes edhe të donatorëve për këta artikuj.

Personeli dhe Organika

Personeli i këtij institucioni përbëhej nga 24 veta, por në momentin e inspektimit ishin 23 vetë, pasi 1 pozicion kujdestar ishte vakant. *Me vendimin nr. 369, datë 24.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, është emëruar në detyrë punonjësi social, Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollore (6-18 vjeç), Shkodër.* Duhet theksuar që ky rekrutim është bërë në përputhje me standardet dhe procedurat që zbaton Shërbimi Social. Organika e Institucionit përbëhej nga drejtori, punonjësi social që ishte përgjegjës i sektorit social, psikologu, 5 edukatorë të gjithë me arsim të lartë, 9 kujdestarë-me arsim të mesëm (1 prej të cilëve është vend vakant), një përgjegjës sektorit të administratës dhe financiar, 2 kuzhinierë, 3 sanitarë dhe një punëtor mirëmbajtës.

Për më tepër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 mësues i arsimit profesional

1-20 fëmijë- 1 infermier

1-20 fëmijë- 1 mjek i përgjithshëm.

Asnjë nga kërkesat e standardeve nuk përmbushet.

Nga verifikimi i dosjeve të personelit rezulton se pjesa më e madhe e punonjësve të këtij institucioni kanë një kohë relativisht të gjatë të punësuar aty, mbi 10-15 vjet. Punësimi i stafit bëhet në zbatim të Kodit të Punës, por procedura e rekrutimit e edukatoreve, psikologut, etj (shpallja, kandidatet, testimi) etj, nuk publikohen në stendat e informimit të publikut që ka bashkia apo edhe në faqen e internetit të bashkisë, veprime të cilat tregojnë mungesën e transparencës në procesin e punësimit të stafit. Nga ana tjetër, mungesat në staf të institucionit bën që personeli ekzistues përveç ngarkesës në punë, këtij stafi i ngarkohen detyra të tjera, gjë e cila lë mangësi të theksuara në përmbushjen e detyrës funksionale të tyre, shërbimi dhe përkujdesja ndaj fëmijëve.

Në dosjet e punonjësve mungonin librezat shëndetësore dhe certifikatat e trajnimeve të bëra për shkak të punës.

Përsa i përket Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve, në Bashkinë Shkodër, kjo punonjëse kishte arsimin bazë Gjuhë-Letërsi dhe ishte duke vazhduar Fakultetin e Shkencave Sociale, Dega Punë Sociale. Ndërkohë që ka shumë vite në këtë pozicion dhe është e trajnuar në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një mjekë me kohë të pjesshme por mungonte ndihmës mjeku. Një kujdestare e stafit të institucionit mbulonte dhe detyrën e ndihmës mjekes. Mjekja e këtij institucioni mbulonte si mjekë familjeje Qendrën Shëndetësore e lagjes Naim Gjylbegu.

Fëmijët e këtij institucioni, nuk ishin të pajisur me karta shëndeti, pasi ishin në proces të plotësimit të të gjithë dokumentacionit përkatës. Për fëmijët që kishin nevojë për trajtim medikamentoz nuk aplikoheshin receta me rimbursim, por ilaçet siguroheshin me një fond buxhetor të posaçëm të institucionit të planifikuar në çdo fillim viti.

Vaksinimi i fëmijëve në këtë shtëpi kryhej sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të.

Në këtë institucion kishte 2 fëmijë të diagnostikuar me Epilepsi dhe një fëmijë me Autizëm, ndërsa 8 fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale, arsimimi I të cilëve ofrohej nga shkolla “3 Dhjetori”, shkollë kjo specifike për fëmijët me zhvillim të vonë mendor.

Edukimi dhe aktivitetet

Institucioni realizonte sipas planeve mujore aktivitete të ndryshme, dhe çdo fillim viti. Nga psikologu hartohej plani vjetor i aktiviteteve për të gjithë fëmijët e institucionit. Kështu për tu vlerësuar ishte krijimi i një ekipi handbolli të vajzave, ku aktivizoheshin 10 vajza të institucionit dhe një mësues i edukimit fizik vinte 3 herë në javë. Po ashtu disa fëmijë i kanë regjistruar në kurse futbollit e disa të tjerë në kurse italishteje, muzike dhe teatri. Ndërkohë që “Ajax school” zhvillonte dhe kurse interneti për fëmijët.

Kutia e ankesave ishte e vendosur në ambientet e institucionit, e kyçur, çelësin e së cilës e mbante Shërbimi Social Shtetëror Rajonal dhe sipas Rregullores ajo hapej me procedurë të përcaktuar, me komision.

Regjistri i takimeve të fëmijëve me të afërmit apo prindin mbahej dhe nënshkruhej rregullisht. Kryesisht këto takime realizoheshin në fundjavë, dhe nënshkruante edhe prindi që takonte fëmijën në zyrën e psikologut si dhe nga edukatori përkatës. Për ata prindër që jetonin larg dhe nuk kishin mundësi pagimi të biletës, ajo ju mundësohej nëpërmjet pagimit nga institucioni.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetës e zhvillimit të këtyre fëmijëve duhet të jetë i një rëndësie të veçantë, nisur dhe nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Kjo në funksion të garantimit të rritjes së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore.

Sa më lart megjithëse në kuadrin e decentralizimit të shërbimeve shoqërore e për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të mirërritjes, mirë edukimit e zhvillimit të këtyre fëmijëve po ju drejtohem bashkërisht si Bashkisë ashtu dhe Shërbimit Social Shtetëror.

Në mënyrë që ky institucion i përkujdeset publik rezidencial për fëmijët të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,

REKOMANDOJMË

▪ ***Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e këtij institucioni. Deri në mbylljen e këtij institucioni,***

1. *Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e çdo forme të dhunës fizike e psikologjike, si dhe çdo forme të neglizhencës në përmbushjen e detyrave ndaj fëmijëve nga ana e stafit, në Shtëpinë e Fëmijës Shkollore (6-18 vjeç) Shkodër.*

2. *Marrjen e masave për parandalimin e çdo forme keqtrajtimi të fëmijëve, përfshi këtu abuzimin dhe shfrytëzimin e tyre për punë fizike në këtë institucion.*

3. *Marrjen e masave administrative ndaj stafit të kësaj shtëpie fëmijësh për veprimet dhe mosveprimet ndaj rasteve të dhunës të ushtruara ndaj fëmijëve.*

4. *Marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve për mirërritjen e fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës Shkollore (6-18 vjeç) Shkodër.*

5. *Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror për rishikimin e politikave sociale për mbështetjen e fëmijëve jetimë socialë (pra që kanë prindërit biologjik), duke mbështetur e subvencionuar familjet përkatëse, në mënyrë që ata të kthehen dhe të rriten në mjedisin e tyre familjar e jo në institucion të përkujdesit rezidencial.*

6. *Marrjen e masave për dhënien prioritet shërbimeve të tjera alternative, siç është procesi i marrjes në kujdestari të fëmijëve nga familjet kujdestare, në zbatim të legjisllacionit në fuqi³⁸.*

³⁸ Vendim Nr. 89, Datë 26.1.2012 “Për Përcaktimin e Kriteve, të Dokumentacionit dhe të Procedurës së Shërbimit të Kujdestarisë”

7. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin në organikën e institucionit të një mjeku të përgjithshëm dhe të një infermieri me kohë të plotë në përputhje me standardet³⁹.

8. Marrjen e masave të menjëhershme për shtimin në organikën e institucionit me psikolog, punonjës social, në përputhje me standardet⁴⁰.

14. Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve

Numri i NJMF-ve duhet rritur, duke siguruar punonjës të mbrojtjes së fëmijëve në profilin e duhur (punonjës socialë) dhe në numër të mjaftueshëm. Përvoja e këtyre viteve ka treguar që vetëm një person në këto Njësi nuk mund të mbulojë radhën e gjatë të detyrave që Ligji “Për të Drejtat e Fëmijëve” i ka përcaktuar. Nevojitet përshkrimi i mirë i punës së punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve.

Politika më të qarta duhen hartuar kanë për parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, si dhe mbrojtjen e fëmijëve në kontekste të ndryshme duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve në institucione dhe në familje; duke përcaktuar më mirë e më qartë me ligj përgjegjësitë e strukturave të ndryshme në nivel vendor lidhur me mekanizmin e përgjigjes ndaj situatave të rrezikut që i kanosen fëmijëve. Përmirësimi i nivelit profesional të punonjësve që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijëve, në fushën e shërbimeve sociale, rendit, arsimit dhe shëndetësisë.

Megjithëse Udhëzimi katër ministror për procedurat për mbrojtjen e fëmijës dhe standardet e cilësisë së shërbimit të NJMF, rezulton se kapacitetet e këtyre strukturave në nivel vendor janë të kufizuara.

-Interesi më i mirë i fëmijëve kërkon ngritjen e shërbimeve të specializuara dhe të integruara për forma të veçanta abuzimi, si abuzimi seksual, ku të bashkëpunojnë punonjës socialë, psikologë, avokatë, punonjës policie, prokurorë dhe gjykatës.

.-Ligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” ka parashikuar NJDF dhe NJMF si struktura për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme, që veprojnë në nivel vendor.

Edhe pse ligji ka përcaktuar ngritjen e një Njësie të Mbrojtjes së Fëmijëve që ofron një gamë shumë të gjerë shërbimesh si ndërgjegjësuere e parandaluese e deri tek menaxhimi i rasteve në rrezik, aktualisht ky funksion nëpër Bashkitë e vendit kryhet nga vetëm një person. Mungesa e përkohshme e këtij personi do të krijonte boshllëk të plotë në shërbim.

³⁹ VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

⁴⁰ VKM nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Këto Njësi nuk kanë mbështetjen e duhur financiare nga buxheti vendor për trajtimin e rasteve, e po ashtu mungojnë shërbimet e emergjencës në rastet e fëmijëve në rrezik të lartë. Ndaj NJMF-të nuk arrijnë të adresojnë nevojat komplekse të fëmijëve në rrezik.

15. KONKUZIONE DHE REKOMANDIME

Pas një analize të gjerë situatës së fëmijëve të institucionalizuar, institucioni i Avokatit të Popullit arrin në konkluzionin se fëmijët e institucionalizuar janë ende shumë dhe shumë pak bëhet për parandalimin e institucionalizimit të tyre.

Nga i gjithë ky proces të krijohet ideja e një labirinti strukturash shtetërore që monitorojnë këto institucione.

Roli i Avokatit të Popullit do të vijojë në ndihmë të secilës ankesë të të rinjve, fëmijëve apo familjarëve, në mënyrë që të arrihen shërbime sa më eficientë ndaj tyre nga strukturat e pushtetit vendor. Në nivel makro, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe perspektiven globale, që çdo zyrë ombudsmani ka: atë të promovimit e të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, duke e vënë interesin më të mirë të tyre si parësorin në çdo lloj vendimmarrjeje. Shërbimi e përkujdesi që u kushtohet këtyre fëmijëve nuk duhet të synojë vetëm mirërritjen e mbrojtjen nga keqtrajtimet, por edhe përgatitja e tyre për të ardhmen. Nuk mundet të flasim për fëmijët dhe të drejtat që ata kanë, pa pretenduar të flasim për varfërinë, e cila shpesh përbën një nga faktorët e neglizhencës ndaj fëmijëve. Varfëria ndikon në jetën e fëmijëve, zhvillimin e tyre dhe integrimin në shoqëri.

Reforma që është ndërmarrë mbi de institucionalizimin është një reformë shumë e rëndësishme nëse ajo do të vijojë në të gjitha institucionet publike. Procesi i de institucionalizimit kërkon integrim më të mirë politikash në fushat e luftës ndaj varfërisë dhe rrezikut të përjashtimit social; të drejtave të fëmijëve dhe mbështetjes së familjeve. Decentralizimi i shërbimeve sociale në Shqipëri sjell detyrime për pushtetin vendor që të hartojë politika të qarta me fokus fëmijët. Deri tani në drejtim të decentralizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror nëpërmjet mundësisë së futjes së shërbimeve alternative (shtëpi-familje, qendra ditore, shërbime në komunitet etj) tentativat më shumë janë bërë nga sektori privat që shpesh nuk është i koordinuar nga shteti. Ligjërish janë ngarkuar njësitë e qeverisjes vendore dhe posaçërisht administratorët shoqërorë që të identifikojnë familjet kujdestare, të ndihmojnë në procesin e aplikimit në gjykatë, të bëjnë vlerësimin e familjes kujdestare dhe fëmijës dhe të përgatisin raport përputhshmërie. Të gjithë jemi të vetëdijshëm që kur fëmija kalon një kohë cilësore në ambientin e tij familjar me prindërit dhe të afërmit, kur këta të fundit janë të përgjegjshëm për misionin në rritjen e mirëdukimit e fëmijëve, fëmijët fitojnë vetëbesimin, rriten duke qenë të vlerësuar dhe të veçantë. Në këtë mënyrë u mësohet atyre ideja e respektit dhe e dinjitetit

njerëzor. Dhe vetëm në këtë mënyrë ata do të aftësohen për të gjetur në të ardhmen vendin e tyre në shoqëri.

Strategjia Evropiane e Zgjerimit 2020, vendos theksin te shndërrimi i këtyre institucioneve në qendra të përkujdesit ditor për fëmijët, duke shmangur kështu jo vetëm institucionalizimin e fëmijëve, por duke mbështetur prindërit e tyre për punë, gjë e cila do të çojë që fëmijët të kthehen në ambientin familjar, për kujdes e mirërritje.

Rasti i dhunës ndaj fëmijës në Institucionin e Përkujdesit Shoqëror për fëmijët 3-6 vjeç në Shkodër; në Shtëpinë e Foshnjës Durrës si dhe në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor 6-18 vjeç Shkodër, nga ana e kujdestareve të këtyre institucioneve (që rritin dhe edukojnë të mitur jetimë) solli në vëmendje se në institucionet e kujdesit për fëmijët ka prani dhune. Ky është një tregues i rëndësishëm i përdorimit jo rastësor apo episodik të dhunës, që ushtrohet ndaj fëmijëve, pikërisht nga ata të cilët kanë detyrën të garantojnë mirëqenien dhe mbrojtjen e tyre. Rasti tregon domosdoshmërinë e monitorimit më efektiv të identifikimit dhe të ankimimit të çdo rasti dhune, neglizhimi, abuzimi, shfrytëzimi apo trajtimi poshtërues ndaj fëmijëve. Testimi i përgjithshëm i stafeve të qendrave të përkujdesit social në të gjithë vendin, duket që nuk është tregues se dhuna u zhduk nga këto institucione.

Fenomeni i dhunës ndaj fëmijëve është sa i përhapur, aq edhe i fshehtë. Dhuna ndaj fëmijëve lidhet me mentalitetin e familjes shqiptare, e cila si një nga format e edukimit të fëmijës përdor edhe ndëshkimin. Ky mentalitet, ndonëse po tronditet, ende ekziston.

Organizata Botërore e Shëndetit ka përcaktuar se: *“Keqtrajtimi ose abuzimi i fëmijës është çdo formë e keqtrajtimin fizik dhe/ose emocional, abuzim seksual, neglizhim apo trajtim neglizhues apo shfrytëzimi për qëllime tregtimi apo të tjera, të cilat shpien në dëmtime të mundshme në shëndetin e fëmijës, mbijetesën, zhvillimin apo dinjitetin e tij në kontekstin e marrëdhënies së përgjegjësive, apo abuzimi me pushtetin”*⁴¹

Institucionalizimi i fëmijëve nuk është zgjidhja përfundimtare e reduktimit të varfërisë së tyre. Çdo shoqëri që ka fëmijë të mirë ushqyer, të strehuar, të mbrojtur, të edukuar, të shëndetshëm dhe të zhvilluar, është një shoqëri që mbron të tashmen dhe investon për të ardhmen, sepse ky përjashtim i dyfishtë i këtyre kostove, kthehet në një përfitim të dyfishtë për të gjithë shoqërinë. Shteti duhet të sigurojë që familjeve t’u jepet mundësia dhe e drejta për të përdorur format e mbështetjes në rolin kujdestar që ata kanë.

Mbledhja e të dhënave është mjaft e rëndësishme për kryerjen e analizave të vlerësimit të realizimit të të drejtave të fëmijëve e për të hartuar politika.

⁴¹ WHO 1999.

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe ndërtimi i kapaciteteve për auditim të brendshëm dhe të jashtëm duhet të shihet gjithashtu si kusht parësor për një ndërveprim dinamik midis niveleve të ndryshme të qeverisë.

Të gjithë profesionistët apo punonjësit që janë në kontakte të vazhdueshme me fëmijët, siç mund të jenë edukatorët, kujdestarët, mësuesit, mjekët, duhet të jenë të trajnuar me format e identifikimit dhe procedurat e raportimit, në mënyrën më të mirë të mundshme.

-Vëllezërit dhe motrat që aktualisht kanë lidhje midis tyre, parimisht nuk duhet të ndahen nga njëri-tjetri kur vendosen nën përkujdesje alternative nëse nuk ekziston ndonjë rrezik i qartë abuzimi apo justifikime të tjera në të mirë të interesave të fëmijëve. Në secilin rast, duhet bërë çdo përpjekje për t'i mundësuar vëllezërve dhe motrave që të ruajnë kontaktet me njëri-tjetrin, përveç rasteve kur kjo është në kundërshtim me dëshirën ose interesat e tyre.

NJMF funksionojnë pranë njësive vendore. Në realitet deri më tani këto njësi ende nuk janë mbështetur me buxhet dhe nuk janë forcuar përsa i përket stafit. Kjo ka ndikuar në mungesën e efektivitetit të punës së tyre. Niveli i ndërmjetëm i sistemit të mbrojtjes së fëmijës, ai rajonal (NjDF-të), në disa qarqe janë shkurtuar ose pezulluar (për mungesë buxheti) që nuk shkon njësh me strategjinë e përmirësimit dhe forcimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Prioritet në reformën e shërbimeve shoqërore duhet të ketë fuqizimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel lokal, hartimi i planeve të de institucionalizimit dhe fuqizimi i shërbimit të kujdestarisë.

Bazuar në problematikat kryesore të konstatuara gjatë inspektimeve të kryera në këto qendra rezidenciale, paraqesim disa rekomandime të detajuara si më poshtë vijon:

1. Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme për ndryshimet e nevojshme për shtesa në organikat e institucioneve të mësipërme rezidenciale në përputhje me Standardet dhe Procedurat për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së këtyre qendrave. Gjithashtu rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme për rekrutimin e stafit sipas përcaktimeve të standardeve, nëpërmjet procedurave transparente si dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit, me theks luftën kundër keqtrajtimit dhe dhunës ndaj fëmijëve.
2. Rekomandojmë në plan afatgjatë marrjen e masave për mbylljen e këtyre qendrave si qendra të përkujdesit rezidencial dhe shndërrimin e tyre në qendra të përkujdesit ditor. Deri në realizimin e këtij rekomandimi kërkohet marrja e masave për kalimin e të gjitha institucioneve rezidenciale vetëm në varësi të drejtpërdrejtë të pushtetit vendor, në kuadër të decentralizimit të këtyre shërbimeve, që do të

thotë marrjen e masave nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për hartimin e akteve përkatëse ligjore dhe nënligjore për të bërë të mundur këtë proces.

3. Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve materiale në të gjitha institucionet rezidenciale si lagështira, ambientet e përbashkëta, dushe, tualete, shkallët e emergjencës etj, si dhe marrjen e masave për vënien në funksion të sistemeve qendrore të ngrohjes/ftohjes, bombolave kundër zjarrit etj. Marrjen e masave për shtesa fondesh në buxhet për një automjet për çdo institucion, për rregullimin e transportit të fëmijëve në kopshte, shkolla, qendra shëndetësore, apo aktivitete të ndryshme jashtë këtyre institucioneve.
4. Rekomandojmë marrjen e masave nga pushteti vendor (bashkitë), për de institucionalizimin e fëmijëve duke fuqizuar ekonomikisht familjet që kanë fëmijët në këto institucione. Fondet të cilat shpenzohen nga shteti për mbajtjen e fëmijëve në këto institucione, të rialokohen për mbështetjen e këtyre familjeve. Rregullimin e procedurave dhe shmangien e burokracive duke lehtësuar procesin e kujdestarisë si dhe rishikimin e fondeve të buxhetit të shtetit, për shtimin e pagesës për familjet kujdestare në interesin më të mirë të fëmijëve.
5. Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme për të mundësuar procedurat e transferimit në kohë të fëmijëve që kanë mbushur moshën, në institucione të përshtatshme për ta, pasi ky proces aktualisht është shumë i gjatë.
6. Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme për një shërbim shëndetësor të unifikuar për funksionimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve nëpërmjet kartave të shëndetit me të cilat janë të pajisur të gjithë fëmijët. Gjithashtu rekomandojmë që kontrolli mjekësor i fëmijëve të kryhet në mënyrë rigoroze, sipas standardeve të përcaktuara të periodicitetit.
7. Rekomandojmë marrjen e masave të menjëhershme për shmangien dhe eliminimin e çdo forme dhune fizike dhe psikologjike nga ana e stafit ndaj fëmijëve të institucionalizuar. Marrjen e masave urgjente për rregullimin me akt nënligjor të çështjes së “punës së fëmijëve” për shmangien e çdo forme pune të detyruar të kryer nga fëmijët e institucionalizuar.
8. Rekomandojmë ngritjen e NJMF-ve në të gjitha bashkitë e vendit, fuqizimin e NJMF-ve ekzistuese duke shmangur mbivendosjen e detyrave të NJMF-së me ato detyra që duhen mbuluar nga staf tjetër si p.sh punonjësi i barazisë gjinore apo Administratori Shoqëror.

Pyetja me të cilën e mbyllim këtë raport, e që shtröjmë për diskutim e për veprim është:

“A e ka Shqipëria sot një Plan Kombëtar të qartë për de institucionalizimin e sistemit të Përkujdesjes ndaj fëmijëve”?
